**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë*
*Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Departamenti për Patentë Shoferë dhe Automjete*
*Odeljenje za vozačke dozvole i vozila Department for*
*Driver's License and Vehicles*

**Grup autorësh**

# DORACAK PËR DHËNIEN E PROVIMIT PËR PATENTË SHOFERË PËR KATEGORINË "B"

***Doracak i autorizuar nga Ministria***
***2024***

# DORACAK PËR DHËNIEN E PROVIMIT PËR PATENTË SHOFERË PËR KATEGORINË B

**Autorë:**
**Habib Hasani, Xhevat Gashi, Avni Abdyli, Vlora Hasanramaj, Reshat Sylejmani, Burim Deliu, Mirditë Emini**

**Recensentë:**

**Fejzulla Mustafa**
**Shkumbim Leka**

**Bashkëpunëtorë profesional**

**Ruzhdi Matoshi**
**Ekrem Latifi**

**Lektorimi:**
**Merlinda Spahiu**

**Fotografitë:**

**Autorët**

**Burime nga interneti**
**Burimet tjera**

***Prishtinë 2024***

***Ndalohet botimi, fotokopjimi apo shfrytëzimi i këtij doracaku për përfitime materiale edhe në mënyrë fizike apo/dhe elektronike.***
***Ky doracak nuk lejohet në asnjë mënyrë të shitet as për t'i mbuluar shpenzimet e shtypjes apo përdorimit elektronik.***
***Moszbatimi i kushteve të sipërshënuara përbënë vepër penale të marrjes së autorësisë për përfitime materiale.***

## Përmbajtja

Kapitulli 1......................................................................5- 25

Kapitulli 2......................................................................26-45

Kapitulli 3......................................................................46-56

Kapitulli 4......................................................................57-87

Kapitulli 5......................................................................88-90

Kapitulli 6......................................................................91-92

Kapitulli 7......................................................................93-96

Kapitulli 8......................................................................97-110

Kapitulli 9......................................................................110-119

Literatura..........................................................................120

## *Parathënie*

Ky doracak u hartua nga grupi punues i autorizuar nga Ministria bazuar në ***planprogramin bazë për dhënien e provimit për patentë shoferi për të gjitha kategoritë*** e automjeteve nga ***PJESA TEORIKE,*** e që është në përputhshmëri të plotë me Direktivat Evropiane për Patentë shoferë.

Doracaku në fjalë ka për qëllim që kandidati si shofer i ardhshëm të njihet dhe të kuptojë domethënien e sinjalizimit rrugor, rregullat, sigurinë në trafik, indentifikimin e rreziqeve në rrugë, teknikën dhe Eko-ngasjen, përdorimin dhe funksionimin e pajisjeve të automjetit, duke shmangur materien që nuk ka kurrfarë ndikimi në të, si p.sh. përbërja e materialit, dimensionet dhe mënyra e vendosjes së sinjalizimit rrugor, instalimi i pajisjeve në automjet, pyetjet administrative, etj.

Shumica e fotografive (ilustrimeve) të përdorura në këtë doracak janë të njëjta me ato që përdoren në pyetjet publike, ashtu që kandidatëve për shoferë apo përdoruesve të tjerë t'u mundësohet që të mos i mësojnë në mënyrë mekanike përgjigjet e sakta në pyetjet publike për kategorinë B, që pastaj hasin në vështirësi gjatë zbatimit të rregullave të trafikut dhe sigurisë gjatë ngasjes.

Ne si grup punues jemi të vetëdijshëm se gjatë hartimit të këtij doracaku mund të ketë ardhur deri te ndonjë lëshim qoftë teknik apo i natyrës tjetër, prandaj, ju lutemi përdoruesve të dorcakut në fjalë që të mos ngurrojnë dhe të na shkruajnë për çfarëdo lëshimi eventual, rekomandim apo sugjerim tuajin qëllim mirë. Ndërsa ne do t'ju jemi mirënjohës e falenderues dhe njëkohësisht do t'i marrim parasysh ato, në mënyrë që botimi tjetër i radhës të jetë edhe më cilësorë dhe më praktik se ky i tanishmi.

*Autorët*

# 1. RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

## RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar t'iu përmbahen rregullave të trafikut, shenjave të trafikut të vendosura në rrugë, semaforëve, si dhe shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar.

Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me shenjat e trafikut të vendosura në rrugë edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e përgjithshme të trafikut.




*Piramida e rregullimit të trafikut rrugor*

Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me semaforët edhe kur kjo dallon nga dispozitat e trafikut për përparësinë e kalimit të shprehur në të njëjtin vend me shenjë tjetër të trafikut.

Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave që i japin personat e autorizuar, edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e caktuara të trafikut ose nga domethënia e shenjave të trafikut të vendosura në rrugë ose dritave në semaforë.

## MBIKËQYRJA DHE RREGULLIMI I TRAFIKUT

Mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut të mjeteve, shoferëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në trafikun rrugor e kryejnë:

- pjesëtarët e policisë,
- mbikëqyrësi ose mësimdhënësi që udhëheq nxënësit në mënyrë të organizuar duke dhënë shenjë për ndalim të trafikut, me qëllim të kalimit të sigurt të fëmijëve në rrugë, dhe,
- personat e autorizuar të hekurudhës, në vendkalimet hekurudhore gjatë kohës së ardhjes së trenit.




*Polici i trafikut*

# *MJETET E TRANSPORTIT PUBLIK*

Shoferi i mjetit, i cili lëviz pranë mjetit të transportit publik të udhëtarëve ose pranë autobusit me të cilin kryhet transporti për nevoja personale i ndalur në vendndalim të autobusëve, duhet të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe me kujdes të shtuar, ashtu që të mos i rrezikojë personat të cilët hyjnë ose dalin nga mjeti.



*Hyrja e autobusit në shiritin e trafikut*

Shoferi duhet ta ndalë mjetin e vet mbrapa mjetit të transportit publik kur personat gjatë hyrjes ose daljes nga mjeti duhet të kalojnë nëpër shiritin e trafikut, nëpër shtegun apo shiritin e biçikletave ose shiritin në të cilin lëviz mjeti.



*Autobusi i cili transporton fëmijë/nxënës*

## *Transporti i organizuar për fëmijë dhe nxënës*

Shoferi i mjetit i cili lëviz **prapa mjetit** që transporton fëmijë, përkatësisht nxënës, dhe shoferi i mjetit i cili vjen **përballë** në rrugë me një shirit të trafikut të caktuar për trafik në një drejtim, **duhen të ndalen** kur mjeti me të cilin transportohen fëmijët është ndalur në rrugë derisa fëmijët hyjnë ose dalin nga ai mjet.



*Hyrja e autobusit në trafik*

## *Vendndalimi i autobusëve*

Gjatë afrimit të vendndalimit të shënuar për autobusë, brenda vendbanimit, shoferi i mjetit detyrohet që ta zvogëlojë shpejtësinë dhe nëse është e nevojshme, të ndalet, ***në mënyrë që t'ia mundësojë shoferit të autobusit apo të ndonjë mjeti tjetër i cili kryen transportin publik të udhëtarëve që të hyjë në trafik,*** nëse shoferi i mjetit që kryen transport publik të udhëtarëve sinjalizon me treguesin e drejtimit synimin e tij që ta ndërrojë shiritin e trafikut ose të lëvizë nga vendndalimi i autobusit në rrugë.

### *Vendndalimi i autobusit të shkollës*



*Vendndalim i autobusit të shkollës*

Kur afrohet te vendndalimi i autobusit të shkollës, shoferi i mjetit duhet ta ndalë mjetin nëse shoferi i autobusit që ndodhet në vendndalim ka dhënë shenjë për ndalje të autobusit.

Shoferi i mjetit duhet ta zvogëlojë shpejtësinë dhe, nëse është e nevojshme, ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ia mundësojë shoferit të autobusit të shkollës të lëvizë në rrugë ose në shiritin më të afërt të trafikut, nëse shoferi i autobusit sinjalizon që do ta bëjë një veprim të tillë.

## *VEPRIMET ME MJETIN NË TRAFIK*



*Lejohet tejkalimi i dy mjeteve përnjëherë*

Shoferi, i cili në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, si: hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, **tejkalimin,** anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo në të majtë, kthimin gjysmërrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashme, **lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë.**

Para ndërmarrjes së veprimeve me mjet në trafik, shoferi duhet të ketë kujdes për pozitën e mjetit, për drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjes.

### *Detyrimet e shoferit para se të ndërmerrë ndonjë veprim*



*Vetura ka sinjalizuar për kthim majtas*

Para se të ndërmerrë ndonjë veprim në trafik, shoferi i mjetit duhet t'i paralajmërojë qartë dhe me kohë pjesëmarrësit e tjerë në trafik për qëllimin e tij, duke dhënë sinjal me anë të treguesve të drejtimit gjatë gjithë kohës së kryerjes së manovrimit dhe ta ndërpresë sinjalin menjëherë pas përfundimit të veprimit. Nëse nuk ekzistojnë treguesit e drejtimit, veprimin duhet paralajmëruar duke dhënë shenjë përkatëse me dorë.

Shoferi i mjetit është i obliguar të sinjalizojë me tregues të drejtimit edhe pasi ta ketë kryer tejkalimin dhe synon të kthehet në shiritin e trafikut në të cilin ka lëvizur para se ta bëjë tejkalimin e mjetit tjetër.

## *HYRJA NË TRAFIK*

Hyrja në trafik ndodh atëherë kur mjeti fillon të lëvizë nga ndalja që nuk ka rezultuar nga rrethanat ose dispozitat e trafikut, ose kur mjeti del nga parkimi në rrugë, ose kur hyn në rrugën qarkulluese nga rruga apo sipërfaqja ku nuk zhvillohet trafiku publik.



*Hyrja në rrugën qarkulluese nga rruga e dheut*

Gjatë hyrjes në trafik, shoferi duhet të ketë kujdes të posaçëm dhe t'i japë përparësi çdo mjeti tjetër apo pjesëmarrësi tjetër të trafikut.



*Ndotja e rrugës me baltë*

Shoferi i cili me mjet hyn nga rruga e dheut në rrugë të shtruar duhet ta ndalë mjetin dhe ta heqë baltën nga rrotat.

## *LËVIZJA E MJETEVE*

Shoferi detyrohet ta drejtojë mjetin në anën e djathtë të kahut të lëvizjes së rrugës. Për lëvizje të mjetit të vet, shoferi duhet ta shfrytëzojë vetëm rrugën, përkatësisht shiritin e trafikut dhe shtegun e caktuar për lëvizjen e atij lloji të mjeteve të cilit i takon mjeti, përveç në rast të rrezikut.



*Lëvizja e veturës në anën e djathtë të rrugës*

Në çdo rrugë të pashënuar me vija ndarëse, shoferi është i detyruar ta drejtojë mjetin sa më afër skajit të djathtë të rrugës. Nëse shiritat në rrugë janë të shënuar, shoferi duhet ta drejtojë mjetin nëpër mesin e shiritit të trafikut.

## *Lëvizja brenda vendbanimit*

Në rrugët brenda vendbanimit me sipërfaqe rrugore në të cilat për lëvizje të mjeteve në të njëjtin kah ekzistojnë të paktën dy shirita të trafikut, shoferi për lëvizje me mjetin e vet mund ta shfrytëzojë edhe shiritin e trafikut që nuk ndodhet pranë skajit të djathtë të rrugës, në qoftë se me këtë nuk i pengon mjetet e tjera që lëvizin pas mjetit të tij.



*Lëvizja në zonë urbane*

Dispozita e lartcekur nuk ka të bëjë me shoferin e mjetit që në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se 40 km/h, me shoferin e triçikletës, të katërçikletës, të traktorit, të makinës së punës dhe të motokultivatorit, përveç në pjesën e rrugës para kryqëzimit ose para vendit tjetër në të cilin mjeti kthehet në të majtë.

Në rrugën për lëvizje të mjeteve në të dy kahet, e cila ka katër apo më shumë shirita të trafikut, shoferit nuk i lejohet të kalojë me mjetin e vet në shiritin rrugor që shërben për lëvizje të mjeteve nga kahu i kundërt.



*Rruga me tre shirita në dy kahe*

Kur në rrugën për lëvizje të mjeteve në dy kahe ekzistojnë tre shirita të trafikut, shiriti i mesëm shfrytëzohet varësisht prej sinjalizimit rrugor. Shoferit të mjetit nuk i lejohet të lëvizë me mjetin e vet nëpër shiritin e trafikut që ndodhet pranë skajit të majtë të rrugës në kah të lëvizjes së mjetit.

Në rrugë në të cilën shiritat rrugorë janë të ndarë fizikisht njëri prej tjetrit, shoferit nuk i lejohet ta lëvizë mjetin e vet nëpër shiritin rrugor që shërben për lëvizje të mjeteve nga kahu i kundërt.

## *Lëvizja prapa*

Nëse shoferi i mjetit synon të lëvizë prapa me mjetin e vet, këtë mund ta bëjë në një pjesë të shkurtër të rrugës vetëm nëse nuk i pengon ose nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

Kur shoferi lëviz prapa me mjet, ai duhet të lëvizë në atë anë të rrugës në të cilën ka lëvizur deri atëherë. Kur shoferi i mjetit lëviz prapa, ai duhet t'iu japë përparësi mjeteve të cilat vijnë prapa mjetit të tij.



*Lëvizja prapa ndalohet:*

- në autoudhë dhe në motoudhë,
- në vendkalime hekurudhore,
- në vendkalime të këmbësorëve,
- në vendkalime të biçikletave,`
- në kryqëzime të padukshme dhe në pjesë të rrugës me fushëpamje të kufizuar,
- gjatë kohës me dukshmëri të dobësuar
- aty ku ndalohet ndalja, dhe,
- aty ku pengohet dhe rrezikohet trafiku rrugor.

## SHPEJTËSIA E LËVIZJES

Shoferi duhet t'ua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psikofizike dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna - brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht, të mund të veprojë me kohë.



*Ngasja në kushte atmosferike*

Shoferit nuk i lejohet që pa shkaqe të arsyeshme të lëvizë me mjet aq ngadalë sa të shkaktojë pengesë ose rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

Kur shpejtësia e lëvizjes së mjetit është përgjysmë më e vogël sesa shpejtësia e lejuar për atë rrugë ose për atë pjesë të saj, shoferi i atij mjeti duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit, përveç nëse e shfrytëzon dritën vezulluese rrotulluese.

### *Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda vendbanimit*




*Ngasja brenda zones urbane - dy shirita për një kah*

***Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonës urbane është 50 km/h, në qoftë se me shenja të trafikut nuk është e përcaktuar ndryshe.***

## *Shpejtësia më e madhe e lejuar jashtë vendbanimit*



*Rrugë Nacionale*

Në rrugë jashtë vendbanimit shoferit nuk i lejohet që të lëvizë me mjet me shpejtësi më të madhe sesa është e caktuar me shenjë të trafikut, e më së shumti
- në rrugë nacionale me dy shirita për një kah me ndarje fizike të shiritave rrugorë - 100 km/h
- në rrugë nacionale me një shirit të trafikut për një kah, në rrugë rajonale dhe në rrugë lokale - 80 km/h.

## *Kufizimi i shpejtësisë*




*Vetura duke tërhequr kampshtëpizën*

Shpejtësia e lëvizjes sipas kategorive të mjeteve në rrugët e tjera, përveç në autoudhë e në motoudhë, kufizohet:
- 80 km/h, për automjete të cilat tërheqin rimorkio për kampim
- në 40 km/h, për traktorin klasik, si dhe për mjetin i cili e tërheq mjetin tjetër të prishur.

Kur drejtohet automjeti i cili tërheq rimorkio për kampim, traktori klasik, apo mjeti i cili e tërheq mjetin tjetër të prishur (defekt), shoferët janë të detyruar t'i përmbahen shpejtësisë së lëvizjes sipas kategorive të tyre edhe në rrugë në të cilën me rregullat e trafikut ose me shenjë të trafikut është lejuar shpejtësi më e madhe.



*Kthimi djathas*

Shoferët e mjeteve të cilat e kanë kufizimin e shpejtësisë sipas kategorisë së mjeteve, janë të obliguar që ta vendosin shenjën e kufizimit të shpejtësisë në anën e prapme të mjetit, në vend të dukshëm. Kjo vlen edhe për mjetet të cilat nuk mund të lëvizin me shpejtësi më të madhe se 30 km/h.

### *KTHIMI*

*Shoferi i mjetit që kthehet djathtas duhet ta bëjë kthimin duke lëvizur nëpër shiritin e skajshëm të trafikut që shtrihet përgjatë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës*, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.

Gjatë kthimit djathtas, shoferi është i detyruar t’i lëshojë mjetet që lëvizin nga ana e tij e djathtë nëpër shiritin e trafikut për mjetet e transportit publik.



*Kthimi majtas*

Shoferi i mjetit që kthehet majtas duhet ta bëjë kthimin nëpër shiritin e majtë të skajshëm të trafikut që shtrihet pranë vijës së mesit dhe nëpër harkun e paramenduar ose të shënuar që lidh dy vijat e mesit të sipërfaqeve anësore të rrugës, nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.



*Kthimi majtas në rrugë me një kah*

Kthimi majtas në rrugë me një kah, bëhet nëpër shiritin e trafikut që shtrihet përgjatë skajit të majtë të rrugës në trafik me rrugë me një kah, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.

Rregullat për kthim nuk zbatohen nëse dimensionet e mjetit nuk e mundësojnë kthimin sipas kësaj rregulle.



*Kthimi majtas me një shirit për një kah*

Kthimi majtas në rrugë me trafik në të dy kahet e lëvizjes.



*Kthimi mjtas në rrugë dykahëshe me shumë shirita të trafikut.*



*Kthimi majtas nga rruga njëkahëshe me shumë shirita të trafikut në rrugën njëkahëshe me shumë shirita të trafikut.*

*Kthimi majtas në rrugë njëkahëshe në rrugë njëkahëshe*



*Kthimi majtas në rrugë dykahëshe në rrugë me trafik në një kah*



*Kthimi majtas në rrugë njëkahëshe në rrugë me trafik në një kah të lëvizjes*



*Kthimi majtas në rrugë njëkahëshe në rrugë me trafik në dy kahe të lëvizjes*

## Kthimi gjysmërrethor

***Kthim gjysmërrethor*** – kthim i mjetit për 180 shkallë nga kahu i deritashëm i lëvizjes me qëllim të ndërrimit të kahut të lëvizjes.



*Ndalim kthim gjysmërrethor*

Shoferit nuk i lejohet ta bëjë kthimin gjysmërrethor me mjet:

-në tunele, në ura,
- në nënkalime dhe në mbikalime,
-në kushtet e dukshmërisë së dobësuar, përkatësisht të fushëpamjes së pamjaftueshme të rrugës,
- në pjesën e rrugës me gjerësi të pamjaftueshme,
- nëse gjatë kthimit kalon në sipërfaqen e ngritur të rrugës,
- në rrugë me një kah,
- ku ndalohet me shenjë të trafikut.



*Kthimi gjysmërrethor në kryqëzim - T*

## TRAFIKU NË KRYQËZIM

Kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai duhet të lëvizë me kujdes të shtuar, në mënyrë që t'iu përshtatet kushteve të trafikut në kryqëzim dhe ta kuptojë mënyrën e rregullimit të trafikut në kryqëzim. Kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai është i obliguar të lëvizë me shpejtësi të tillë që të mund të ndalet dhe t'i lëshojë pjesëmarrësit e trafikut të cilët kanë përparësi kalimi në kryqëzim.
Shoferi i mjetit është i detyruar që në largësi të mjaftueshme para kryqëzimit ta marrë drejtimin me mjet në atë shirit të trafikut nëpër të cilin duhet ta lëshojë kryqëzimin.



*Trafiku në kryqëzim*

Shoferit me mjet nuk i lejohet hyrja në kryqëzim nëse dendësia e trafikut është e tillë që në rast se do të ndalet në kryqëzim ose në vendkalim të këmbësorëve, ai do ta pengojë ose do ta pamundësojë trafikun e mjeteve të cilat vijnë nga rrugët anësore të kryqëzimit ose lëvizjen e këmbësorëve.

### Rregulla e krahut të djathtë

Gjatë afrimit të një kryqëzimi me rëndësi të njëjtë, kur kryqëzimi nuk është i rregulluar me shenja të trafikut, shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të veçantë dhe t'i japë përparësi mjetit që vjen nga krahu i tij i djathtë (rregulla e krahut të djathtë).





*Vetura e verdhë ka përparësi kalimi*





*Vetura e kuqe kthehet majtas - lëviz e fundit*

Kur shoferi i mjetit në kryqëzim ***kthehet majtas***, ai është i obliguar t'i japë përparësi mjetit i cili duke ardhur nga kahu i kundërt në kryqëzim lëviz drejt ose kthehet djathtas, përveç në qoftë se me shenjat e trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.



*Rradhitja e kalimit në këtë kryqëzim është:*
***Vetura e gjelbër, unë, vetura e kuqe.***

*Vlenë rregulla e krahut të djathtë*

## *Kryqëzimi i rregulluar me shenja të trafikut*





Rregulla e krahut të djathtë nuk zbatohet për mjetin i cili lëviz nëpër binarë i cili ka përparësi kalimi në të gjitha rastet, **përveç nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe**.

Rradhitja në këtë kryqëzim: ***Mopedi, tramvaji, unë***

*Tramvaji duhet t'i jap përparësi kalimi mopedit*







Shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë me përparësi kalimi, është i obliguar t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat qarkullojnë në atë rrugë.

*Rradhitja e kalimit në këtë kryqëzim është:*
***Biçiklisti, unë, kamioni.***

*Unë duhet të ndalem para shenjës STOP*

Rregulla e krahut të djathtë vlen edhe nëse mjetet lëvizin nëpër rrugën dytësore në rast se lëvizjet e tyre ndërpriten.





Kur mjetet që lëvizin në kryqëzim nëpër rrugën me përparësi kalimi nga kahu i kundërt, në rast se lëvizjet e tyre ndërpriten, vlen rregulla e krahut të djathtë.

*Unë lëviz para veturës së kuqe*

## *Shtrirja e rrugës me përparësi kalimi*

Në kryqëzim ku përparësia e kalimit është rregullar me shenjë trafikut - me tabelë plotësuese, mjetet që lëvizen në shtrirje të rrugës kryesore kanë përparësi kalimi.



***Vetura e kuqe dhe biçiklisti kanë përparësi kalimi.***

*Shtrirja e rrugës me përparësi kalimi është në anën e djathtë*



Në këtë kryqëzim vetura e gjelbër lëviz në shtrirje të rrugës me përparësi kalimi (kryesore).

Vetura e gjelbër ka përparësi kalimi.

Unë lëviz në rrugën sekondare (dytësore).

*Vetura e gjelbër ka përparësi kalimi*





Në këtë kryqëzim unë lëviz në shtrirje të rrugës me përparësi kalimi.

*Unë lëviz i pari*

Shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë nga sipërfaqja në të cilën nuk zhvillohet trafik publik, qoftë ajo rrugë dheu, oborr, depo, fabrikë apo e ngjashme, duhet t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin nëpër rrugën ku hyn edhe atëherë kur kjo rrugë nuk është e shënjuar si rrugë me përparësi kalimi.

### *Kryqëzimi i rregulluar me semaforë*

Në kryqëzim të rregulluar me semaforë, shoferi vepron sipas domethënies së dritës në semafor edhe nëse është në kundërshtim me rregullën e krahut të djathtë apo me shenjat e trafikut që rregullojnë përparësinë e kalimit.







Në këtë kryqëzim respektohet domethënia e dritave në semafor e jo shenja e trafikut STOP.

*Unë vazhdoj lëvizjen pa u ndalur*



Ndërmjet mjeteve të cilat në kryqëzim me semaforë në të njëjtën kohë e kanë kalimin të lirë, vlen rregulla e krahut të djathtë.

Në këtë kryqëzim respektohet domethënia e dritave në semafor e jo shenja e trafikut.

*Duhet të ndalem para kryqëzimit*







Drita e verdhë vezulluese nuk e rregullon përparësinë e kalimit - respektohet shenja STOP.

*Unë duhet të ndalem para shenjës STOP*

### *Kryqëzimi me rreth rrotullim*

Në kryqëzim me rrethrrotullim vlejnë rregulla të njëjta sikurse në kryqëzime të tjera.
Kryqëzimi me rrethrrotullim me një shirit të trafikut për një kah, nuk paraqet ndonjë vështirësi, se hyrja dhe të gjitha daljet bëhen vetëm nga një shirit i trafikut.
Në kryqëzim me rrethrrotullim me dy shirita për një kah, shiriti i djathtë i skajshëm i trafikut përdoret për daljen e parë dhe të dytë, ndërsa shiriti i majtë përdoret për daljen e dytë, tretë .... dhe për ndryshimin e kahjes së lëvizjes.
Shoferi duhet t'i zbatojë rregullat gjatë ngasjes në kryqëzim me rrethrrotullim me dy shirita për një kah, siç është paraqitur në figurën vijuese:




Dalja e parë dhe e dytë - trajektorja e lëvizjes me ngjyrë të kaltër.

Dalja e dytë, e tretë dhe ndërrimi i kahjes së lëvizjes me ngjyrë të kuqe.

*Kryqëzim me rrethrrotullim me dy shirita për një kah*

Në kryqëzim me rrethrrotullim me tre apo më shumë shirita të trafikut për një kah, hyrjet dhe daljet bëhen sipas sinjalizimit rrugor.

### *Kryqëzimi i rregulluar me polic*

Kur kryqëzimi është i rregulluar me polic pjesëmarrësit në trafik duhet të veprojnë sipas urdhrave dhe shenjave të policit edhe nëse domethënia e tij ndryshon nga rregulla e krahut të djathtë, shenjat e trafikut apo nga domethënia e dritave në semaforë.



Vetura e verdhë edhe pse e ka driten e kuqe në semafor vazhdon lëvizjen pasi sipas pozitës së policit e ka kalimin e lirë.

*Kryqëzim i rregulluar me polic*

### *Vendkalimi i biçikletave*

Shoferi i mjetit i cili i afrohet vendkalimit të caktuar për biçikleta, duhet të ketë kujdes të veçantë dhe t'i japë përparësi biçiklistit i cili gjendet në vendkalim.



Biçiklisti ka përparësi kalimi dhe lëviz i pari në kryqëzim, pastaj lëviz unë i dyti (rregulla e krahut të djathtë), dhe e fundit lëviz vetura e kaltër.

*Biçiklisti ka përparësi kalimi*



Shoferi i mjetit i cili me rastin e kthimit të mjetit e pret shtegun ose shiritin për biçikleta, duhet t'iu japë përparësi kalimi mjeteve që lëvizin nëpër shiritin ose shtegun për biçikleta.

*Biçiklisi ka përparësi kalimi*

## *PËRBALLËKALIMI*

***Përballëkalim* -** kalim me mjetin rrugor pranë mjetit tjetër i cili lëviz nga kahu i kundërt nëpër të njëjtën rrugë.

Shoferi obligohet që gjatë përballëkalimit të mbajë distancë të sigurt anësore në mes mjetit të tij dhe mjetit ose pjesëmarrësit tjetër në trafik që është duke kaluar përballë dhe, nëse është e nevojshme, të shmanget në anën e djathtë të rrugës ose të ndalet për të mundësuar përballëkalim të sigurt.

Kur përballëkalimi i mjeteve është i pamundur si pasojë e punimeve në rrugë, si pasojë e ndonjë mjeti të ndaluar ose të ndonjë pengese tjetër në rrugë, shoferi i mjetit i cili e ka pengesën në kahun e tij të lëvizjes duhet të ndalet për t'i dhënë përparësi kalimi mjetit që vjen nga kahu i kundërt i rrugës.



Vetura që vjen përballë, duhet të ndalet deri sa ne kalojmë rrugën.

*Përballkalim i rregulluar me shenja të trafikut*



*Unë do të ndalem.*
*Vetura që vjen përballë, ka përparësi kalimi*

*Përballkalimi i rregulluar me shenja trafikut*

Kur në kryqëzim mjetet vijnë nga kahe të kundërta (përballkalimi) dhe kthehen majtas, qendrën e kryqëzimit e kanë nga ana e vet e djathtë.

### *Përballëkalimi në rrugë me pjerrtësi gjatësore*

Në rrugë me pjerrtësi, ku përballëkalimi me mjete të tjera është i vështirë ose i pamundur, shoferi i mjetit që lëviz teposhtë duhet të ndalet dhe të pozicionohet sa më afër skajit të rrugës, në mënyrë që t'ia mundësojë përballëkalimin mjetit i cili lëviz përpjetë. Shoferi i mjetit që lëviz përpjetë duhet ta ndalë mjetin e vet në rast se para vetes ka vend të përshtatshëm për ndalim, për ta mundësuar përballëkalimin e sigurt të mjetit që lëviz teposhtë.

Në rrugë me pjerrtësi në të cilën përballëkalimi është i vështirësuar ose i pamundur, kurse njëra nga mjetet detyrohet të lëvizë prapa me qëllim të mundësimit të qarkullimit, këtë duhet ta bëjë:

- çdo mjet i cili takohet me mjetin që tërheq mjet të bashkëngjitur,
- mjeti i lehtë i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë,
- mjeti i cili lëviz teposhtë, në qoftë se mjetet janë të së njëjtës kategori.




*Përballëkalimi në rrugë me pjerrtësi gjatësore*

## TEJKALIMI

***Tejkalim*** **-** kalimi me mjet pranë mjetit tjetër rrugor që lëviz në të njëjtin kah.

***Para fillimit të tejkalimit, shoferi duhet të sigurohet se:***

- ekziston fushëpamje dhe hapësirë e mjaftueshme që ta bëjë veprimin e tejkalimit pa i penguar dhe pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor,

- shoferi i mjetit që lëviz prapa tij nuk e ka filluar veprimin e tejkalimit,



Fushëpamje e mirë e rrugës.

*Lejohet tejkalimi*

- shoferi që ndodhet në mjetin përpara tij në të njëjtin shirit të trafikut nuk ka dhënë shenjë se ka për qëllim ta tejkalojë ndonjë mjet tjetër, ta ndryshojë drejtimin e lëvizjes apo ta ndërrojë shiritin e trafikut,



*Nuk lejohet tejkalimi*

- në rrugë ka hapësirë të mjaftueshme për realizim të plotë të tejkalimit, duke e pasur parasysh diferencën ndërmjet shpejtësisë së tij dhe të mjetit që tejkalohet, si dhe distancën dhe shpejtësinë e mjeteve që vijnë nga krahu i kundërt;

- pas tejkalimit nuk do të bëjë manovrime të rrezikshme dhe të kthehet sa më parë që të jetë e mundur në shiritin e trafikut në të cilin ka lëvizur para tejkalimit, pa e penguar ose rrezikuar mjetin të cilin e tejkalon.

### *Distanca anësore e sigurisë*

- Gjatë tejkalimit shoferi i mjetit duhet të ushtrojë kujdes të veçantë dhe të mbajë distancë të sigurt anësore ndaj mjetit të cilin e tejkalon ose ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.



Në rast të tejkalimit të mjetit me dy rrota ose të kolonës së këmbësorëve, distanca anësore e sigurisë duhet të jetë së paku 1 metër.

*Edhe Tejkalim i biçikletës - distanca anësore së paku 1 m*

## *Rregullat e tejkalimit*



*Tejkalimi i mjetit bëhet nga ana e majtë, por mund të bëhet edhe nga ana e djathtë:*

- kur mjeti tjetër, i cili ndodhet përpara mjetit në të njëjtin kah, në rrugë ka zënë pozitë pranë skajit të majtë të shiritit dhe shoferi i tij jep sinjal për kthim në anën e majtë,

*Tejkalimi bëhet nga ana e djathtë*



- mjeti mbi binarë të vendosur në mes të rrugës, në qoftë se midis atij mjeti dhe skajit të djathtë të rrugës ekziston shiriti i trafikut.

*Tejkalimi bëhet nga ana e djathtë*

## *Detyrimet e shoferit, mjeti i të cilit tejkalohet*

Shoferi, të cilit i është dhënë sinjal se mjeti pas tij po synon ta tejkalojë mjetin nga krahu i tij i majtë, duhet t'iu përmbahet këtyre rregullave:

- duhet ta largojë mjetin e tij kah skaji i djathtë i rrugës,
- nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë gjatë kohës gjersa tejkalohet.



*Tejkalimi bëhet nga ana e majtë*

***Ndalohet tejkalimi:***

- në vendet ku është i ndaluar me shenja të trafikut,
- drejtpërdrejtë para vendkalimit hekurudhor,
- në vendkalim ose mbi binarë në të njëjtin nivel,
- drejtpërdrejtë para dhe në vendkalim të këmbësorëve dhe në vendkalim të biçiklistëve,
- në shiritin për nxitim, në shiritin për ngadalësim, në shiritin për ndalje të detyrueshme,
- para dhe në kurriz rruge, para dhe në kthesë të padukshme,



- një shirit trafiku për një kah,

*Nuk lejohet tejkalimi - një shirit i trafikut për një kah*



- përveç në rrugën qarkulluese që ka më së paku dy shirita të trafikut për lëvizje të mjeteve në një kah.

*Lejohet tejkalimi - dy shirita të trafikut në një kah*



*Lejohet tejkalimi i motokultivatorit*

Lejohet të kalohet me mjet përtej vijës së plotë të pandërprerë gjatësore vetëm në rastet kur tejkalimi bëhet pranë mjeteve pa motor dhe pranë mjeteve me veprim motorik të cilat nuk zhvillojnë shpejtësi mbi 30 km/h, si traktorët, motokultivatorët, mopedët etj.



*Lejohet tejkalimi*

Në tunel ndalohet tejkalimi, përveç nëse ekzistojnë dy ose më tepër shirita të trafikut në një kah.

***Ndalohet tejkalimi i këtyre mjeteve:***



*Kolona e automjeteve*

- mjetet nën përcjellje dhe me përparësi kalimi kur ato janë në intervenim,
- i kolonës së mjeteve,
- i mjetit i cili është ndalur ose është duke u ndalur për shkak të lëshimit të këmbësorëve në rrugë.

Tejkalimi ndalohet edhe në këto situata:

- nëse me këtë veprim do të rrezikohet siguria e trafikut ose do të pengohet trafiku nga kahu i kundër,

- nëse pas kryerjes së tejkalimit apo anashkalimit, mjeti nuk mund të kthehet në shiritin e trafikut nga i cili ka lëvizur më parë pa i penguar ose pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

## *Tejkalimi në kryqëzim*

Shoferit nuk i lejohet ta tejkalojë mjetin tjetër drejtpërdrejtë para kryqëzimit dhe në kryqëzim i cili nuk është me rrethrrotullim, përveç në këto situata:

- kur mjeti tjetër i cili ndodhet përpara mjetit kthehet majtas, kurse tejkalohet nga ana e djathtë,
- kur gjatë tejkalimit të mjetit tjetër që kthehet djathtas, me mjetin e vet nuk kalon në pjesën e rrugës së paraparë për trafikun nga kahu i kundërt;
- kur mjeti lëviz në rrugë me përparësi kalimi,
- në kryqëzim në të cilin trafiku rregullohet me semaforë ose nga personi i autorizuar.

Shoferit të mjetit i lejohet ta tejkalojë biçikletën, mopedin ose motoçikletën pa rimorkio anësore drejtpërdrejt para kryqëzimit dhe në kryqëzim i cili nuk është me rrethrrotullim.

## *Lëvizja në rreshta paralelë*



*Lëvizje në rreshta paralelë*

Në rrugën në të cilën ekzistojnë të paktën dy shirita të trafikut të paraparë për qarkullim të mjeteve që lëvizin në kahe të njëjta dhe në të cilën ndodhet kolonë e mjeteve, shoferit nuk i lejohet me mjet të kalojë nga një shirit në shiritin tjetër. Shoferi mund ta lëshojë shiritin në të cilin ndodhet vetëm në rastet kur pozicionohet që të kthehet në anën e majtë ose të djathtë, apo për parkim të mjetit.

Në rrugët brenda zonës urbane sipas kushteve të sipërshënuara, lëvizja më e shpejtë e mjetit në një shirit sesa në shiritin tjetër, si dhe kalimi pranë mjetit që lëviz ngadalë e që nuk e shfrytëzon shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut, nuk konsiderohet tejkalim.

## *Anashkalimi*

Me anashkalim nënkuptojmë kalimin me mjet pranë një mjeti tjetër të ndalur a të parkuar, ose pranë një objekti që gjendet në shiritin e trafikut nëpër të cilin lëviz mjeti rrugor.

Në qoftë se në mes të rrugës ndodhet ishulli për këmbësorë, ose është e shënuar hapësira për parkim të mjeteve, ose është ndonjë sipërfaqe tjetër që nuk është e caktuar për trafik të mjeteve, ose është ndonjë objekt a mekanizëm tjetër, - atëherë shoferi i mjetit duhet t'i anashkalojë ato nga ana e djathtë.



*Anashkalim nga të dy anët*

Në qoftë se sipërfaqet, objektet a mekanizmat ndodhen në mes të rrugës me një kah, shoferi i mjetit mund t'i anashkalojë ato nga ana e djathtë ose e majtë, në qoftë se me shenja të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.

## SINJALET PARALAJMËRUESE TË DRITËS DHE ZËRIT

Shoferi i mjetit duhet të japë sinjale zëri apo drite kur është e domosdoshme për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit e tjerë mbi rrezikun në rrugë.

### Sinjalet paralajmëruese të zërit

Shoferi obligohet që t'i përdorë sinjalet paralajmëruese të zërit kur e kërkon nevoja e sigurisë së trafikut, e sidomos:

- në rrugë jashtë zonës urbane, për ta paralajmëruar pjesëmarrësin tjetër në trafik që dëshiron të tejkalojë ose të anashkalojë, ku mosdhënia e këtij sinjali do të rrezikonte shkaktim të aksidentit në trafik,

- në qoftë se pranë rrugës gjenden fëmijë të cilët nuk i kushtojnë vëmendje qarkullimit të mjeteve.

### Sinjalet paralajmëruese të dritës

- Prej muzgut të parë deri në agimin e plotë, shoferi i mjetit, në vend të sinjalit të zërit për paralajmërim, si rregull e përdor sinjalin e paralajmërimit me drita. Këtë sinjal shoferi i mjetit mund ta përdorë edhe në zonën urbane, gjatë tejkalimit të mjetit tjetër.

- Sinjali i paralajmërimit me dritë jepet duke përdor në mënyrë alternative dritat e shkurta me të gjata.

### Ndezja e të gjithë tregueseve të drejtimit

Shoferi i mjetit në rrugë publike është i detyruar t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit - nëse në mjet janë të instaluara, si në vijim:

- gjatë kohës së hyrjes apo daljes së udhëtarëve,
- nëse i paralajmëron pjesëmarrësit e tjerë në trafik për rrezikun në trafik,
- gjatë kohës së dukshmërisë shumë të vështirësuar, si pasojë e mjegullës së dendur, tymit e të ngjashme,
- nëse është mjeti i fundit i ndalur në kolonën e cila është e ndalur në rrugë jashtë zonës urbane, përveç nëse kolona është e ndalur të veprojë sipas dispozitave apo shenjave të trafikut,
- gjatë drejtimit mbrapa,
- nëse ndalet në rrugë qarkulluese, përveç me rastin e parkimit në vendin e shënuar, përkatësisht për të vepruar sipas rregullave apo shenjave të trafikut.

## NDALJA DHE PARKIMI

Me rregulla të trafikut shoferit nuk i lejohet ta ndalë dhe ta parkojë mjetin në vendin ku do ta rrezikonte sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në trafik ose do ta pengonte zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve.

Shoferi i cili e ndal ose e parkon mjetin në rrugë publike është i detyruar ta ndalë, përkatësisht ta parkojë atë sa më pranë cepit të djathtë të sipërfaqes së rrugës qarkulluese.

***Me rastin e ndaljes ose parkimit të mjetit në rrugë jashtë zonës urbane, mjeti duhet të ndalet ose të parkohet jashtë rrugës qarkulluese.***

Shoferi i cili ka qenë i detyruar ta ndalë mjetin mbi binarë, detyrohet menjëherë ta largojë atë nga binarët, ose nëse nuk ka mundësi t'i marrë të gjitha masat në mënyrë që të lajmërohet me kohë personi i cili e drejton mjetin mbi binarë.

### *Parkimi në trotuar*




*Ndalohet parkimi në trotuar në këtë situatë*

Lejohet parkimi i mjetit në trotuar nëse gjerësia e trotuarit për lëvizjen e lirë të këmbësorëve është së paku 1, 6 metra dhe nuk duhet te jetë pranë skajit të djathtë të rrugës qarkulluese dhe e shënuar me shenja të trafikut rrugor.

Shoferi mund ta parkojë mjetin e vet në vendet që ndodhen në mes të sipërfaqes së rrugës, vetëm kur këto vende janë të shënuara si vendparkim me shenja të trafikut rrugor.

### *Vendet ku ndalohet ndalja dhe parkimi i mjetit*

Është e ndaluar ndalja e mjetit në këto vende:

- në kthesë të padukshme dhe në kurriz rruge,
- në tunel, në nënkalim e mbikalim, mbi urë,
- në kryqëzim dhe në largësi më të vogël se 5 metra nga skaji më i afërt i rrugës tërthore,




*Ndalohet ndalja dhe parkimi i veturës*

- në vendkalim të këmbësorëve, në vendkalim të biçikletave, si dhe në distancë më të vogël se 5 m para vendkalimit të tillë.

¶

- në shtegun dhe shiritin për biçikleta,
- në vendndalim të autobusëve,
- nëse mjeti do ta mbulonte shenjën apo sinjalin e trafikut në afërsi më të vogël se 10 metra,
- në rrugë ku shiritat rrugorë janë të ndarë fizikisht ndërmjet tyre, vetëm nëse lejohet me shenja të trafikut,

- në shteg të këmbësorëve,
- në skaj të majtë të rrugës, me përjashtim të ndaljes apo parkimit brenda zonës urbane në rrugë në një kah;
- në brez ndarës ndërmjet shiritave rrugorë,
- në vend të rezervuar për parkim të mjetit për personat me aftësi të kufizuara,
- në trotuar, me përjashtim aty ku lejohet parkimi,




- në pjesën e rrugës ku gjerësia e kalimit të lirë prej mjetit të ndalur ose të parkuar deri te vija e plotë gjatësore e mesit e shënuar në rrugë do të ishte më e vogël se 3 metra,

*Ndalohet ndalja dhe parkimi i veturës*

¶




- përkatësisht deri te skaji tjetër i rrugës më e vogël se 4 metra.

*Ndalohet ndalja dhe parkimi i veturës*

¶

***Ndalohet parkimi i mjeteve në këto vende:***

- në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga garazhi, nga porta, apo të ngjashme dhe ku mund ta pengojë trafikun,




- në vendin ku shkakton pengesë për mjetin tjetër për t'u parkuar apo për të dalë nga vendparkimi,

*Ndalim prakimi*

*Ndalohet parkimi*

- në distancë më të vogël se 15 metra para ose mbrapa vendndalimit të autobusit apo shenjës së trafikut që e shënon këtë vendndalim;



- mbi kapakët e rrjetit të ujësjellësit, të kanalizimit ose të rrjeteve të tjera të shërbimeve komunale, apo të ngjashme.

*Ndalohet parkimi*



Parkimi i automjetit në teposhtëze bëhët në këtë mënyrë;

- *tërhiqet freni i parkimit;*
- *ndërruesi i shpejtësisë vihet në pozitë për lëvzije mbrapa (rikverc;*
- *rrota kthehen në anën e djathtë.*

*Parkimi i automjetit në teposhtëze*



Parkimi i automjetit në përpjetëze bëhët në këtë mënyrë;

- *tërhiqet freni i parkimit,*
- *ndërruesi i shpejtësisë vihet në shpejtësinë e parë,*
- *rrota kthehen në anën e majtë.*

*Parkim i automjetit në përpjetëze*

## *MJETI NË DEFEKT*

Shoferi duhet të shënojë ndaljen e mjetit kur është e ndalur në rrugë qarkulluese për shkak të prishjes, aksidentit ose për ndonjë arsye tjetër, vetëm në vendin ku ndalohet ndalja dhe parkimi sipas rregullave të parapara.

Ndalja e mjetit duhet të shënohet duke i ndezur të gjithë treguesit e drejtimit (nëse nuk i funksionojnë të gjithë treguesit e drejtimit i ndezë dritat e pozicionit nëse janë në dispozicion) dhe vendosur trekëndëshin e sigurisë parapa mjetit të ndalur.

Trekëndëshi i sigurisë vendoset:



- brenda zonës urbane në distancë prej së paku **10** metra,

- jashtë zonës urbane në rrugë nacionale, rajonale dhe lokale jashtë zonës urbane, në distancë prej **30 deri në 50 metra,**

*Trekëndëshi i sigurisë jashtë zonës urbane*



- në autoustradë dhe moto udhë në distancë së paku **100 metra.**

*Trekëndëshi i sigurisë në autoudhë*

***Shënimi i mjetit në defekt është i detyrueshëm gjatë tërë kohës së ndalimit të mjetit.***



Kolona e mjeteve, bashkësia e mjeteve dhe mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme, kur janë në defekt i vendosen dy trekëndësha të sigurisë, sipas rregullave të sipër shënuar.

*Trekëndëshi i sigurisë*

Nëse mjeti është i ndalur prapa kthesës, trekëndëshi i sigurisë vendoset para kthesës.

***Nëse shoferi gjendet jashtë mjetit të vet në rrugën qarkulluese, ai është i detyruar ta mbajë jelekun reflektues.***

## *Tërheqja e mjetit të prishur ose në defekt*

Shoferi i mjetit mund ta tërheqë mjetin tjetër, përveç mjeteve të bashkëngjitura, vetëm nëse mjeti tjetër nuk mund të lëvizë vetë për shkak të prishjes apo në mungesë të ndonjë pjese.

Mjeti në defekt mund të tërhiqet me litar apo me pajisje të ngurtë, duke u mbështetur ose duke u varur në mjetin tërheqës.

### *Detyrimet gjatë tërheqjes së mjetit në defekt*

Në mjetin e tërhequr si rezultat i prishjes ndalohet transporti i personave.

Mjeti i cili tërhiqet duhet të jetë i lidhur për mjetin që e tërheq, në atë mënyrë që të përjashtohet mundësia e shkëputjes së tyre gjatë lëvizjes.



*Tërheqja e veturës në defekt*

Gjatë kohës së tërheqjes së mjetit ne defekt, ***të dy mjetet*** duhet të jenë të shënuara me ***trekëndëshin e sigurisë***. Në mjetin i cili tërheq, trekëndëshi vendoset ***në pjesën e përparme***, ndërsa në mjetin e tërhequr në ***anën e prapme***.

Në të dy mjetet, gjatë tërheqjes se mjetit ne defekt duhet të jenë të ndezur të gjithë ***treguesit e drejtimit***, nëse janë të instaluar në mjet, nëse mjeti nuk i ka të instaluar të gjithë treguesit e drejtimit, ai është i detyruar t'i ndezë dritat e pozicionit.

### *Ndalohet tërheqja me litar e mjetit defekt:*

- nëse sistemi i tij i frenimit dhe i drejtimit është jashtë funksionit,
- nëse për funksionim të sistemit të frenimit të mjetit që tërhiqet, nevojitet që motori të punojë, ndërsa motori është jashtë funksionit.

### *Ndalohet tërheqja me lidhje të fortë e mjetit:*

- i cili mjet e ka jashtë funksionit sistemin e drejtimit (defekt),
- i cili është më i rëndë se mjeti që e tërheq, nëse mjeti që tërhiqet nuk e ka në rregull frenin punues.

### *Kushtet për tërheqjen e mjetit në defekt gjatë dukshmërisë së dobësuar*

Gjatë dukshmërisë së dobësuar (vështirësuar) lejohet tërheqja e mjetit në defekt vetëm nëse i ka të ndezura prapa dritat e kuqe për shënjim të mjetit, d.m.th. dritat e pozicionit, ose nëse tërheqjen e bën mjeti i cili e përdor dritën e verdhë vezulluese rrotulluese.

## *PËRDORIMI I DRITAVE NË TRAFIK*

Automjeti që merr pjesë në trafikun rrugor duhet t’i ketë së paku dy drita të bardha në pjesën e përparme dhe dy drita të kuqe në pjesën e pasme:

- kur automjeti tërheq një ose dy mjete të bashkëngjitura, në pjesën e pasme të mjetit të fundit të bashkëngjitur duhet të jenë të ndezura të paktën dy drita të kuqe

Automjeti i cili merr pjesë në trafikun rrugor duhet t’i ketë në rregull: sistemin e ndriçimit (dritat e shkutra, dritat e gjata, dritat e mjegullës, dritat për ngasje mbrapa), sistemin e sinjalizimit (treguesit e drejtimit, stop dritat,) të pozicionit (dritat gabarite, dritat e tabelës, dhe të ngjashme).

### Mjetet nuk duhet t’i kenë të ndezura dritat e parkimit apo pozicionit:

- mjeti i ndalur ose i parkuar në pjesën e ndriçuar të rrugës që shihet qartë nga një largësi e mjaftueshme,

- mjeti i ndalur ose i parkuar në vende të caktuara në rrugë ose jashtë rrugës, ose në rrugë me intensitet të dobët të trafikut.

### *Përdorimi i dritave*

Për ndriçim të rrugës, shoferi i automjetit përdor dritat e gjata.

### *Dritat e shkurtra për ndriçimin e rrugës përdoren në rastet vijuese:*



*Përdorimi i dritave të gjata jo në rregull*

- gjatë përballëkalimit, kur mjeti tjetër vjen përballë dhe kur njëri nga shoferët e mjetit i ndalë dritat e gjata dhe i ndezë dritat e shkurtra,

- në afërsi të mjetit që lëviz nëpër binarë, të mjetit që lundron ose të ngjashme,



*Përdorimi i dritave të shkurta në rregull*

- kur ekziston mundësia që ta pengojë nga prapa shoferin e mjetit përpara,

- gjatë kohës derisa kalon pranë kolonës të organizuar të këmbësorëve.

## *Dritat gjatë drejtimit nëpër mjegull*

Kur ka mjegull shoferi i automjetit duhet t’i ketë të ndezura në mjet dritat e shkurtra ose ato për mjegull, ose të dy këto drita në të njëjtën kohë.



Dritat për mjegull lejohet të përdoren vetëm kur ka mjegull ose në rast të dukshmërisë së dobësuar (vështirësuar).

Dritat për mjegull të cilat gjinden në pjesën e përparme mund të jenë të ***bardha ose të verdha,*** ndërsa në pjesën e pasme me ***ngjyrë të kuqe.***

*Dritat për mjegull në pjesën e pasme*

Kur dukshmëria të përmirësohet, shoferi i mjetit duhet t’i ndalë këto drita menjëherë.



Gjatë ngasjes nëpër mjegull mund të mos vërehen me kohë këmbësorët dhe mjetet që nuk kanë ndriçim vetjak.

.

*Dritat për mjegull në pjesën e përparme*



***Shoferi i automjetit duhet t’i ketë të ndezura dritat e shkurtra ose dritat e ditës gjatë tërë kohës së drejtimit.***

## *Dritat gjatë drejtimit ditën*

*Gjatë ngasjes ndezja e dritave është e obliguar*

### *Dritat e pozicionit*

Gjatë gjithë kohës së lëvizjes, automjeti duhet t'i ketë të ndezura edhe dritat e pozicionit, përveç dritave të zakonshme për ndriçim të rrugës, respektivisht atyre të veçanta për mjegull.

## *DISTANCA NË MES TË MJETEVE*

Shoferi i mjetit është i detyruar ta mbajë distancën e sigurisë kur lëviz pas mjetit tjetër, duke e pasur parasysh shpejtësinë e lëvizjes, gjendjen, llojin dhe fushëpamjen e rrugës, dukshmërinë, kushtet atmosferike, gjendjen e ngarkesës, gjendjen e vet psikofizike, gjendjen e sistemit frenues etj., në mënyrë që të mos e rrezikojë sigurinë e trafikut, ashtu që në rast se mjeti para tij frenon apo ndalet, shoferi të mund ta ndalë mjetin në mënyrë të sigurt.

***Distanca ndëmjet mjeteve gjatë ngasjes brenda vendbanimit duhet të jetë së paku 1 sekond.***




***Distanca ndëmjet mjeteve gjatë ngasjes jashtë vendbanimit duhet të jetë së paku 2 sekond.***

*Distanca e sigurisë*




***Distanca ndëmjet mjeteve gjatë ngasjes në rrugë të rrëshqitshme duhet të jetë së paku 3 sekond.***

*Distanca e sigurisë*

## RREGULLAT E TRAFIKUT PËR BIÇIKLISTË

Biçiklisti duhet të lëvizë në sipërfaqen e dedikuar për këto mjete, nëse duhet ta shfrytëzojë ritmin qarkullues, duke lëvizur sa ma afër skajit të shiritit të djathtë në distancë deri në ***1 metër***.



*Biçiklisti me jelek reflektues*

Kur biçiklisti qarkullon në rrugë publike gjatë pashmërisë së zvogëluar, ai është i detyruar të ketë jelek reflektues, rroba reflektuese për biçiklistë apo ndonjë burim drite.

Biçikleta duhet ta ketë të ndezur një dritë ngjyrë të bardhë në pjesën e përparme dhe një dritë ngjyrë të kuqe, katadiopter me materie retroreflektuese në pjesën e pasme gjatë drejtimit natën dhe gjatë drejtimit ditën kur dukshmëria është e vështirësuar.

Në vendkalim për biçiklistë, biçiklistit i ndalohet të hyjë me vrull (vrullshëm) para mjetit që vjen ose ta ngadalësojë e ta ndalojë biçikletën pa arsye.

***Biçiklisti më i ri se 16 vjeç duhet ta mbajë helmetën mbrojtëse gjatë drejtimit.***



*Lëvizja e biçiklistëve jo në rregull*

***Ndalohet lëvizja e biçiklistëve pranë njëri – tjetrit.***

# TRAFIKU NË VENDKALIM HEKURUDHOR

## Detyrimet e shoferit gjatë kalimit në vendkalim hekurudhor

Në vendkalim hekurudhor pa mbrojtëse dhe gjysmëmbrojtëse dhe pa sinjale me të cilat paralajmërohet ardhja e trenit, shoferi i mjetit është i obliguar që para se të kalojë nëpër binarë, paraprakisht të sigurohet se në vendkalimin hekurudhor nuk kalon ndonjë mjet.




*Vendkalim hekurudhor pa mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse*

***Shoferi duhet t'i respektojë shenjat të cilat janë të vendosur para vendkalimit hekurudhor.***

***Shoferit i ndalohet:***




*Vendkalim hekurudhor me mbrojtëse ose gjysëm mbrojtëse*

- të kalojë anash mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve dhe të hyjë në vendkalim hekurudhor nën rrethanat kur ulja e mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve tashmë ka filluar ose ka përfunduar, ose kur ngritja e tyre nuk ka përfunduar,

- të hyjë në vendkalim hekurudhor nëse janë të ndezura sinjalet, dritat ose pajisjet akustike me të cilat paralajmërohet ardhja e mjetit në binarë,

- ta kalojë mjetin gjatë kohës që është duke e pritur hapjen e gjysmëbarrierave ose barrierave,
- të hyjë në vendkalim hekurudhor, nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme të lirë në anën tjetër të kalimit për vazhdim të lëvizjes.

# TRAFIKU NË AUTOUSTRADË DHE MOTOUDHË

Ndalohet lëvizja nëpër autoustradë e këmbësorëve, e bagëtisë, e mjeteve pa motorë, e mjeteve me veprim motorik, e automjeteve të cilat për nga vetitë e konstruksionit nuk mund të lëvizin me shpejtësi prej së paku 60 km/h.




Trafiku në autoudhë

Shoferi i automjetit, i cili për shkak të avarisë ose për shkaqe të tjera është i detyruar ta ndalë automjetin në autostradë, duhet ta ndalë automjetin në shiritin e emergjencës dhe duhet t'i ndërmarrë masat në mënyrë që sa më parë ta largojë mjetin nga shiriti i trafikut.

## Kushtet për lëvizje në autoudhë




Trafiku në autoudhë

.

Në autostradë automjetet duhet të lëvizin në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut i cili nuk është i zënë me automjete që lëvizin në kolonë.

Në autostradë lejohet ndërrimi i shiritit të trafikut me qëllim të lëvizjes më të shpejtë vetëm duke kaluar me automjet në shiritin e majtë të trafikut.

**Ndalohet hyrja në autostradë e automjetit që është duke e tërhequr mjetin në defekt.**

## Drejtimi në autostradë me shumë shirita të trafikut

Në autostradë me 3 ose me tepër shirita te trafikut që shërben për lëvizje të automjeteve në një drejtim, shoferi i automjetit me rimorkio me gjatësi mbi 7 metra mund të shfrytëzoj vetëm 2 shirita të trafikut që ndodhën pranë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës.

## Hyrja në autoudhë

Shoferi i cili hyn me automjet në autostradë duhet:

- ta shfrytëzojë shiritin për nxitim, kur ai shirit ekziston, duke dhënë shenjë përkatëse me tregues të drejtimit dhe duke hyrë në rrjedhën e trafikut në atë mënyrë që të mos e rrezikojë trafikun e automjeteve që lëvizin nëpër autostradë,

- t'i japë përparësi kalimi automjetit tjetër i cili lëviz nëpër autostradë, nëse nuk ekziston shirit i posaçëm për nxitim,

- shoferi i cili me mjet lëviz në autostradë duhet t'ia lehtësojë hyrjen në autostradë mjetit tjetër, duke e lënë të lirë shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut dhe duke lëvizur në shiritin majtas prej tij, nëse nuk pengohet lëvizja e mjeteve të tjera në autostradë.

### *Dalja me automjet nga autostrada*

Shoferi i cili del nga autostrada duhet ta marrë pozitën me automjet në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut dhe të kalojë në fillim të shiritit për ngadalësim, në qoftë se një shirit i tillë ekziston në autostradë.

### *Bllokimi i trafikut në autostradë*

Në rast të bllokimit të trafikut në autostradë, automjetet duhet t'ua mundësojnë lëvizjen mjeteve me përparësi kalimi dhe nën përcjellje, duke u skajuar në të djathtë ose në të majtë të shiritit të trafikut për të krijuar hapësirë të lirë kalimi.



***Në autostradë ndalohet:***

- kthimi gjysmërrethor,
- lëvizja mbrapa,
- lëvizja zigzage,
- tejkalimi në shiritin për ndalje emergjente,
- Ngasja në distancë të vogël pas mjetit që lëviz para tij.

## *TRAFIKU NË TUNEL*



*Tuneli me dy shirita për një kahe*

Shoferit që me mjet lëviz nëpër tunel nuk i lejohet: ***ta ndalë ose ta parkojë mjetin, të bëjë kthim gjysmërrethor ose të lëvizë prapa.***

Shoferi i mjetit me veprim motorik gjatë drejtimit nëpër tunel duhet t'i ketë të ndezura dritat e shkurta për ndriçim të rrugës.

## AUTOMJETET NËN PËRCJELLJE

Automjetet nën përcjellje, duke pasur kujdes për sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në trafik, e kanë të drejtën e përparësisë së kalimit kundrejt të gjitha mjeteve të tjera, përveç në kryqëzim ku trafiku rregullohet nga personi i autorizuar.



*Automjetet nën përcjellje*

Automjeti nën përcjellje ka të drejtë të mos i zbatojë dispozitat e trafikut, kur ai me mjet jep sinjale me dritë të kuqe dhe të kaltër dhe sinjale zëri me intensitet të ndryshueshëm, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

### *Sjellja e shoferit ndaj mjeteve në përcjellje*

Shoferi i mjetit i cili e has në rrugë mjetin ose kolonën e mjeteve nën përcjelle, si dhe shoferi të cilin e arrin mjeti nën përcjelle ose kolona e mjeteve nën përcjelle, është i detyruar ta ndalë mjetin e vet, që natën në vend të dritave të gjata t'i përdorë dritat e shkurtra për ndriçim të rrugës, që t'iu përmbahet në mënyrë të përpiktë urdhrave që ia japin personat që i përcjellin mjetet dhe ta vazhdojë lëvizjen vetëm pasi të kalojnë të gjitha mjetet nën përcjelle.

### *Sjellja e këmbësorit ndaj mjeteve në përcjellje*

Për ta bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve nën përcjelle, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga përderisa të mos kalojnë këto mjete.

### *Mjetet me përparësi kalimi*



*Mjeti i emergjencës \ ambulancës*

Mjete me përparësi kalimi konsiderohen:

- *mjeti i Policisë,*
- *mjeti i zjarrfikësve,*
- *mjeti i emergjencës \ ambulances,*
- *mjeti i FSK-së.*

Mjete me përparësi kalimi në trafik janë mjetet, kur me pajime të veçanta japin sinjale me dritë të kaltër dhe me zë me intensitet të ndryshueshëm gjatë intervenimit.

### *Sjellja e shoferit ndaj mjeteve me përparësi kalimi*

Kur shoferi i mjetit takon në rrugë ose arrihet nga mjeti me përparësi kalimi, ai duhet ta lëshojë rrugën e, sipas nevojës, të ndalet derisa të kalojë mjeti me përparësi kalimi dhe të veprojë sipas urdhrit të personit të autorizuar nga mjeti me përparësi kalimi.

*Sjellja e këmbësorëve ndaj mjeteve me përparësi kalimi*

Për ta bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve me përparësi kalimi, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga derisa të kalojnë këto mjete. Pajisjet për dhënie të sinjalizimit të posaçëm me drita dhe me zë me intensitet të ndryshueshëm kanë të drejtë t’i përdorin vetëm mjetet nën përcjellje dhe me përparësi kalimi.

## *SINJALIZIMI RRUGOR*

*Sinjalizimi rrugorë përfshinë:*

- shenjat trafikut/sinjalizimi vertikal,
- shenjat në rrugë/sinjalizimi horizontal,
- semaforët, dhe,
- pajisjet rrugore.

Shenjat e trafikut janë: shenjat e rrezikut, shenjat e urdhrave të prera, shenjat e lajmërimit me ose pa tabelë plotësuese. ~~shenjat në sipërfaqe të rrugës, në trotuar dhe shenjat e tjera në rrugë.~~

*Shenjat e rrezikut*

Shenjat e rrezikut shërbejnë për t’i paralajmëruar pjesëmarrësit në trafikun rrugor për rrezikun që u kanoset në ndonjë vend të caktuar, përkatësisht në një pjesë të rrugës, si dhe për natyrën e këtij rreziku.

*Forma e shenjave të rrezikut*

Shenjat e rrezikut kanë formën e trekëndëshit barabrinjës, përveç shenjës Kryqi i Andreut si dhe panela e cila tregon afërsinë e vendkalimit hekurudhor me ose pa barriera dhe gjysmë barriera.

*Distanca e vendosjes së shenjave të rrezikut*

Shenjat e rrezikut vendosen jashtë vendbanimit në largësi 150 deri 250 m, para vendit të rrezikut në rrugë.

*A - Lloji dhe përmbajtja e shenjave të rrezikut:*

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Rrezik në rrugë» - tregon afërsinë e rrugës ose pjesën e rrugës në të cilën pjesëmarrësve u kanoset rreziku. |  Shenja »Kryqëzim i rrugës me rëndësi të njëjtë». |  Shenja »Kryqëzim i rrugës kryesore me rrugën dytësore nën këndin e drejtë» nga të dy anët. |  Shenja »Lidhje e rrugës kryesore me rrugën dytësore nën këndin e drejtë nga krahu i majtë». |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Lidhje e rrugës kryesore me rrugën dytësore nën këndin e drejtë nga krahu i djathtë». |  Shenja »Lidhje e rrugës kryesore me rrugën dytësore nën këndin e ngushtë nga krahu i majtë» |  Shenja »Lidhje e rrugës kryesore me rrugën dytësore nën këndin e ngushtë nga krahu i djathtë» |  Shenja »Kthesë në të majtë» - shënon afërsinë e vendit të rrugës ku kthesa – kthesat janë të rrezikshme apo rruga nuk ka dukshmëri të mjaftueshme |
|  Shenja »Kthesë në të djathtë» |  Shenja »Kthesë e dyfishtë apo kthesë e shumëfishtë ku kthesa e parë është në të majtë» |  Shenja »Kthesë e dyfishtë apo kthesë e shumëfishtë ku kthesa e parë është në të djathttë» |  Shenja »Teposhtëze e rrezikshme» |
|  Shenja »Përpjetëze e rrezikshme» |  Shenja »Ngushtim rruge » |  Shenja »Ngushtim rruge nga ana e djathtë» |  Shenja »Ngushtim rruge nga ana e majtë» |
|  Shenja »Rrugë jo e rrafshët» (për shkak të gungave në rrugë) |  Shenja »Rrugë jo e rrafshët» (për shkak të lugjeve në rrugë) |  Shenja »Rrugë jo e rrafshët» (për shkak të gungave të njëpasnjëshme dhe lugjeve në rrugë) |  Shenja »Rrugë e rrëshqitshme» - tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën rruga në mot të ndryshueshëm apo në kushte të ngjashme ka sipërfaqe të rrëshqitshme |
|  Shenja »Hedhje gurësh» - tregon afërsinë e vendit të rrugës ku gjendet zalli jo i ngjeshur ose i hedhur në sipërfaqe të rrugës së asfaltuar, ose gurët e imët |  Shenja »Shembje gurësh nga ana e djathtë» - tregon afërsinë e rrugës në të cilën ekziston rreziku nga gurët që bien (shemben) apo nga gurët që janë në rrugë |  Shenja »Arritja te shenjat ndriçuese – semaforët vertikalë» - tregon afërsinë e vendit ku trafiku është i rregulluar me semaforë |  Shenja »Arritja te shenjat ndriçuese – semaforët, horizontalë» - tregon afërsinë e vendit ku trafiku është i rregulluar me semaforë |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Trafik në dy kahe» - shënon vendin në rrugë ku trafiku zhvillohet në dy kahe. |  Shenja »Paralajmërim (afërsia) i kryqëzimit me rrethrrotullim» - tregon afërsinë e kryqëzimit në të cilin trafiku zhvillohet në rrethrrotullim. |  Shenja »Ngricë në rrugë» - tregon pjesën e rrugës në të cilën ekziston rreziku i papritur nga ngricat. |  Shenja »Përmbysja – rrëshqitja e mjeteve» tregon afërsinë e vendit në të cilin ekziston rreziku i rrëshqitjes - përmbysjes së mjetit. |
|  Shenja »Kolonë e ndalur e mjeteve» - tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën në kushte të përcaktuara apo në rrethana të ndryshme ekziston rreziku nga kolona e mjeteve të ndalura në rrugë për shkak të ngescjes në trafik. |  Shenja »Bankinë e paqëndrueshme» - tregon afërsinë e pjesës së rrugës ku bankina përgjatë rrugës është e paqëndrueshme. |  Shenja »Paralajmërim i këmbësorëve në rrugë» - tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën lëvizin këmbësorët. |  Shenja »Paralajmërim i vendkalimit të shënuar për këmbësorë» - tregon afërsinë e vendit në të cilin gjendet vendkalimi i shënuar për këmbësorë. |
|  Shenja »Paralajmërim i fëmijëve në rrugë» - tregon afërsinë e vendit në rrugë ku fëmijët shpesh dhe në numër të madh lëvizin rrugës (p. sh.: para shkollave, kopshteve, çerdheve etj.). |  Shenja »Paralajmërim i pistës së aeroportit - tregon afërsinë e pjesës së rrugës ku aeroplanët fluturojnë ulët para se të ngriten në hapësirë. |  Shenja »Tunel (galeri)» - tregon afërsinë e tunelit apo galerisë në rrugë. |  Shenja »Erërat anësore» - tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën shpesh frynë erërat anësore. |
|  Shenja »Rrezik nga zjarri» - shënon territorin (hapësirën) në të cilin ekziston rreziku nga zjarri. |  Shenja »Paralajmërim i biçiklistëve në rrugë» - tregon afërsinë e vendit të rrugës në të cilën biçiklistët shpesh lëvizin apo gjenden në rrugë nga rrugët anësore ose në shtegun e biçiklistëve. |  Shenja »Urë lëvizëse» - shënon afërsinë e vendit në të cilin rruga kalon përtej urës lëvizëse. |  Shenja »Afërsi e bregut» - tregon afërsinë e vendit në të cilin rruga gjenden në breg. |
|  Shenja »Rrugë e tramvajit» - tregon afërsinë e vendit në të cilin rruga kalon përtej rrugës së tramvajit në nivel |  Shenja »Kafshë në rrugë» - tregon afërsinë në të cilën kafshët shtëpiake me mbikëqyrës kalojnë rrugën përtej apo lëvizin përgjatë saj |  Shenja »Kafshë të egra në rrugë» - tregon afërsinë e rrezikut të veçantë në të cilin kafshët e egra shpesh kalojnë rrugën |  Shenja »Vendkalim hekurudhor i siguruar/ mbrojtur» - tregon afërsinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila sigurohet me barriera ose gjysmëbarriera |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Vendkalim hekurudhor i pasiguruar» - kalimi i rrugës përtej hekurudhës pa barriera dhe gjysmëbarriera tregon afërsinë e kalimit te rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila nuk sigurohet me barriera ose gjysmëbarriera |  Shenja »Kryqi i Andreut» - shënon vendin në të cilin rruga kalon përtej hekurudhës në nivel pa barriera ose gjysmëbarriera me një palë binarë |  Shenja »Kryqi i Andreut» - shënon vendin në të cilin rruga kalon përtej hekurudhës në nivel pa barriera ose gjysmëbarriera me dy ose më shumë binarë |  Shenja »Panele në afërsi të vendkalimit hekurudhor të siguruar» - tregon largësinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila është e siguruar me barriera dhe gjysmëbarriera |
|  Shenja »Panele në afërsi të vendkalimit hekurudhor të pasiguruar» - tregon largësinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila nuk është e siguruar me barriera dhe gjysmëbarriera |  Shenja "punimet në rrugë" tregon vendin ku kryhen punimet në rrugë. | | |

## B - *Shenjat e urdhrave të prera*

Shenjat e urdhrave të prera iu bëjnë me dije pjesëmarrësve në trafikun rrugorë për ndalimet, kufizimet dhe obligimet që duhet t'ju përmbahen.
Shenjat e urdhrave të prera tregojnë rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku, kufizimet dhe obligimet.

### *Forma e shenjave të urdhrave të prera*

Shenjat e urdhrave të prera e kanë formën e rrethit, përveç shenjës ***"Trekëndëshi"*** **-** kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi dhe ***STOP*** **-** ndalje e obligueshme.

### *Vendosja e shenjave të urdhrave të prera*

Shenjat e urdhrave të prera vendosen drejtpërsëdrejti në vendin në të cilin pjesëmarrësve në trafik u fillojnë detyrimet për t'ju përmbajtur urdhrave të parapara me shenja të trafikut.

### *Vlefshmëria e shenjave të trafikut*

Shenja e urdhrave të prera vlen deri te kryqëzimi i parë, deri sa nuk shfyqizohet me shenjë apo me tabelë plotësuese.

Urdhëri i prerë i paraparë në shenjën e ndalimit dhe kufizimit ose të obligimit i vendosur në hyrje të vendbanimit në shtyllën e njëjtë ku është e vendosur shenja e vendbanimit vlen për tërë territorin e vendbanimit, nëse në rrugët e caktuara ose pjesën e rrugës në vendbanimi nuk është përcaktuar ndryshe me ndonjë shenjë të urdhrave të prera.

## *B - Lloji dhe përmbajtja e shenjave të urdhrave të prera*

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi» |   Shenja »Ndalja e obligueshme» - tregon vendin para hyrjes në kryqëzim, në të cilin shoferi është i obliguar që ta ndalë mjetin ... |  Shenja »Ndalim trafiku në dy kahe« |  Shenja »Ndalim trafiku në një kah« |
|  Shenja »Ndalim trafiku për të gjitha mjetet me veprim motorik, përveç motoçikletave pa rimorkiove anësore» |  Shenja »Ndalim trafiku për autobusë« |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete transportuese - kamionë«......me masën më të madhe të lejuar mbi 3.5 tonë |  Shenja »Ndalim trafiku për cisterna« |
|  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që bartin eksploziv ose ndonjë materie lehtë ndezëse« - tregon rrugën ose pjesën e rrugës ku ndalohet trafiku për mjetet të cilat bartin eksploziv ose ndonjë materie lehtë ndezëse |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që bartin materie të rrezikshme« - tregon rrugën ose pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku për mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme |  Shenja »Ndalim trafiku për të gjitha automjetet që tërheqin mjete bashkëngjitëse« - tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku për të gjitha automjete të cilat tërheqin mjete bashkangjitëse |  Shenja »Ndalim trafiku për mjetet transportuese që tërheqin mjetet bashkangjitëse« - tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku për mjetet transportuese të cilat tërheqin mjetet bashkëngjitëse |
|  Shenja »Ndalim trafiku për traktorë« - tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku për traktorë |  Shenja » rafiku për motoçikleta« - regon rrugën, përkatësisht pjesën e rugës në të cilën është i ndaluar trafiku për motoçikleta dhe për riçikletat dhe katërçikletat e rënda |  Shenja »Ndalim trafiku për mopedë - çiklomotorë« - tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar trafiku për mopedë, triçikleta dhe katërçikleta të lehta. |  Shenja »Ndalim trafiku për biçikletë« |
|  Shenja »Ndalim trafiku për biçikletë dhe |  Shenja »Ndalim trafiku për qerre« |  Shenja »Ndalim trafiku për karrocë dore« |  Shenja »Ndalim trafiku për të gjitha automjetet« |

| | | | |
|---|---|---|---|
| moped« | | | |
|  Shenja »Ndalim trafiku për këmbësorë« |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që tejkalojnë gjerësinë e caktuar« |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që tejkalojnë lartësinë e caktuar« |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që tejkalojnë masën e caktuar« |
|  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që tejkalojnë ngarkesën boshtore të caktuar« |  Shenja »Ndalim trafiku për mjete që tejkalojnë gjatësinë e caktuar« |  Shenja »Distanca më e vogël në mes të mjeteve gjatë lëvizjes« . |  Shenja »Ndalim kthimi majtas« |
|  Shenja »Ndalim kthimi djathtas« (B-29) |  Shenja »ndalim kthimi gjysmërrethor« (B-30) |  Shenja »Kufizim i shpejtësisë« |  Shenja »Ndalim tejkalimi për të gjitha automjetet përveç motoçikletës pa rimorkio anësore« (B-32) |
|  Shenja »Ndalim tejkalimi për mjetet transportuese - kamionë« (për mjetet transportuese masa më e madhe e lejuar është mbi 3. 5 tonë) |  Shenja »Ndalim kalimi pa u ndalur – Dogana« |  Shenja »Ndalim kalimi pa u ndalur - Policia« - tregon afërsinë e policisë ku mjeti duhet të ndalet |  Shenja »Ndalim kalimi pa u ndalur - pagesa rrugore« - tregon afërsinë e vendit ku mjeti duhet të ndalet për të paguar pagesën rrugore |
|  Shenja »Ndalim i dhënies së shenjave akustike (zërit)« - tregon rrugën ose pjesën e rrugës ku ndalohet dhënia e shenjave akustike, përveç në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë |  Shenja »Përparësi kalimi për mjetet nga kahu i kundërt« - tregon ndalimin e hyrjes së mjetit në pjesën e ngushtë të rrugës para se të kalojnë mjetet nga kahu i kundërt |  Shenja »Ndalim ndaljeje dhe parkimi« - tregon anën e rrugës ku është e ndaluar ndalja dhe parkimi i mjetit |  Shenja »Ndalim parkimi« - tregon anën e rrugës ku është i ndaluar parkimi i mjetit, ndërsa lejohet ndalja |
|  Shenja »Parkim alternativ« - tregon anën e rrugës ku është i ndaluar parkimi në ditët tek |  Shenja »Parkim alternativ« tregon anën e rrugës ku është i ndaluar parkimi në ditët çift |  Shenja »Ndalim fotografimi« tregon hapësirën pranë rrugës në të cilën është i ndaluar fotografimi, incizimi, skicimi e ngjashëm |  Shenja »Shpejtësi më e vogël e lejuar» |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Pajisje dimërore» - tregon pjesën e rrugës në të cilën automjetet përveç motoçikletave duhet të kenë pajisje dimërore të parapara për kushte dimërore |  Shenja »Shtegu i biçikletave» - tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin biçikletat |   Shenja »Shtegu i këmbësorëve dhe shenja »Shtegu i këmbësorëve dhe biçikletave» - tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin këmbësorët dhe biçiklistët |  Shenja »Shtegu për kalorës» (B-49) – tregon shtegun ku ndalohet lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë në trafik |
|  Shenja »Kah i obliguar drejtë» |  Shenja »Kah i obliguar djathtas» |  Shenja »Kah i obliguar majtas» |  Shenja »Kah i obliguar majtas» |
|  Shenja »Kah i obliguar djathtas» |  Shenja »Kthim gjysmërrethor i obliguar» |  Shenja »Kahe të obliguara drejt dhe majtas» |  Shenja »Kahe të obliguara drejt dhe djathtas» |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  Shenja »Kahe të lejuara djathtas dhe majtas» |  Shenja »Anashkalim i obliguar nga ana e djathtë» |  Shenja »Anashkalim i obliguar nga ana e majtë» |  Shenja »Anashkalime të obliguara - djathtas dhe majtas» |  Shenja »Kryqëzim me rrethrrotullim» |

## C-*Shenjat e lajmërimit*

Shenjat e lajmërimit u japin pjesëmarrësve në trafik njoftime të nevojshme për rrugën nëpër të cilën lëvizin dhe njoftime të tjera të cilat mund të jenë të dobishme (ndërprerja e vlefshmërisë së shenjave të urdhrave të prera, shërbime të ndryshme, etj), si dhe për orientim të trafikut.

### *Forma dhe përmbajtja e shenjave të lajmërimit:*

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Përparësi kalimi në raport me mjetet nga kahu i kundërt« - paralajmëron shoferin që në pjesën e ngushtë të rrugës ka përparësi kalimi ndaj mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt |  Shenja »Vendkalim i shënuar për këmbësorë« |  Shenja »Vendkalim i shënuar për shtegun e biçikletave« |  Shenja »Vendkalim i shtegut për këmbësorë dhe biçikleta« |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja »Fëmijët në rrugë» (C - 05), tregon vendin në cilin fëmijët lëvizin shpesh ose në numër të madh |  Shenja »Nënkalim ose mbikalim për këmbësorë« (BI-06), |  Shenja »Rrugë me trafik në një drejtim« (gjatësore) dhe tërthore) |  Shenja »Rrugë me përparësi kalimi« |
|  Shenja »Mbarim i rrugës me përparësi kalimi« |  Shenja »Gungë në rrugë« - tregon vendin ku vendosen pajisjet për ngadalësim të trafikut |  Shenja »Mbarim i tejkalimit« |  Shenja »Ndalim tejkalimi për mjete transportuese - kamionë« |
|   Shenja »Mbarim i kufizimit të shpejtësisë maksimale« |   Shenja »Mbarim i shpejtësisë më të vogël të lejuar« |  Shenja »Mbarim i ndalimit të dhënies së shenjave akustike - zërit« |  Shenja »Mbarim i të gjithave ndalesave« - tregon vendin në rrugë ku mbarojnë të gjitha ndalesat / kufizimet të cilat më parë kanë qenë të vendosura në atë rrugë |
|  Shenja » Mbarim i ndalimit të përdorimit të pajisjeve dimërore« |  Shenja »Mbarim i shtegut për biçikleta« |  Shenja »Mbarim i shtegut për këmbësorë« |  Shenja »Mbarim i shtegut për kalorës« |
|   Shenja »Zona ku është e kufizuar shpejtësia« |   Shenja »Mbarim i zonës ku është e kufizuar shpejtësia« |   Shenja »Zona e këmbësorëve« nuk lejohet lëvizja e mjeteve përveç atyre me leje të veçantë |   Shenja »Mbarim i zonës së këmbësorëve« |
|  Shenja »Zona e trafikut të qetë« - tregon vendin në zonë urbane në të cilën automjeteve nuk u lejohet të lëvizin me shpejtësi më të madhe se 5 km/h sepse lojërat e fëmijëve janë të lejuara në tërë zonën |  Shenja »Mbarim i zonës së trafikut të qetë« - tregon vendin ku dilet nga zona e trafikut të qetë |   Shenja »Zona ku është e kufizuar kohëzgjatja e parkimit« |   Shenja »Mbarim i zonës ku është e kufizuar kohëzgjatja e parkimit« . |

| | | | |
|---|---|---|---|
|   Shenja »Zona e shkollës« - tregon vendin ku fillon zona e shkollës |   Shenja »Mbarim i zonës së shkollës« - tregon vendin ku mbaron zona e shkollës |   Shenja »Shpejtësia e rekomanduar« e dhënë si shembull |   Shenja »Mbarim i shpejtësisë së rekomanduar« |
|   Shenja »Patrulla shkollore« |   Shenja »Spitali« |  Shenja »Institucioni i ndihmës së shpejtë mjekësore« |   Shenja »Stacioni policor« |
|  Shenja »Vendndalja e autobusëve« - tregon vendin ku duhet të ndalen autobusët |  Shenja »Aeroporti« tregon afërsinë e aeroportit ose vendin e aeroportit |  Shenja »Aparati për shuarjen e zjarrit« tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet aparati për shuarjen e zjarrit ose shërbimi i zjarrfikësve |   Shenja »Udhëtregues« |
|  Shenja » Autostrada« - tregon vendin kur fillon autoudha |  Shenja »Përfundimi i autostrada « - tregon vendin ku përfundon autoudha |  Shenja »Motoudha« - tregon vendin ku fillon motoudha |  Shenja »Mbarim i motoudhës« - tregon vendin ku mbaron motoudha |
|  Shenja »Rruga pa dalje« - tregon afërsinë dhe pozitën e rrugës e cila nuk ka dalje. |  Shenja »Kthimi majtas inderekt« - tregon rrugën në të cilën mjeti duhet të lëvizë deri te ky kryqëzim |   Shenja »Vendi për ndalje të dhunshme të mjetit« |  Shenja BI-75 Shenja »Vendi për ndalje të dhunshme të mjetit» |
|   Shenja »Qafë mali« - tregon qafëmalin me lartësi mbidetare |   Shenja »Lumi« tregon emrin e lumit përtej së cilit kalon rruga |   Shenja »Tuneli« |   Shenja »Ura« |
|   Shenja «Udhëtregues për autostrada dhe motoudhë« - tregon drejtimin kah autoudha dhe motoudha |   Shenja »Vendbanim« |   Shenja »Mbarim i vendbanimit« |   Shenja « Dalje nga autostrada dhe motoudha« |

| | | | |
|---|---|---|---|
|  Shenja «Shiriti i trafikut për mjetet e transportit publik të udhëtarëve« |   Shenja »Kufizimi i shpejtësisë më të madhe të lejuar në rrugët e Kosovës» |  Shenja «Rreshtimi i mjeteve« (C-91) - tregon vendin e rreshtimit në kryqëzim, në rrugën me shumë shirita të trafikut |   Shenja »Rreshtimi i mjeteve sipas emërtimeve të zonave urbaneve» (C-92) tregon vendin e rreshtimit në kryqëzim, në rrugën me shumë shirita të trafikut |
|   Shenja »Parashenja për rregullimin e trafikut manual» - paralajmëron shoferët për afërsinë e vendit ku kryhen punime dhe kur trafiku rregullohet në mënyrë alternative |   Shenja »Parashenja devijim»- tregon kahun dhe drejtimin e devijimit nëpërmes zonës urbane |   Shenja »Udhëtregues për devijim» - tregon drejtimin e përkohshëm të devijimit |  Shenja »Hapja e shiritit të trafikut» |
|  Shenja »Mbyllja (reduktimi) i shiritave të trafikut» - tregon vendin kur mbyllet përkatësisht përfundon një shirit i trafikut për lëvizjen e mjeteve në të njëjtin drejtim |   Shenja »Shpejtësia e lejuar në shirita të caktuar të trafikut» - tregon shpejtësinë më të vogël të lejuar në shirita të caktuar të trafikut |   Shenja »Shiriti i trafikut për mjetet e ngadalshme» - tregon vendin kur fillon shiriti në të cilin duhet të lëvizin mjetet e ngadalshme |   Shenja »Mbarim (mbyllje) i shiritit të trafikut për mjetet e ngadalshme» - tregon vendin kur mbaron shiriti për mjete të ngadalshme |
|  Shenja »Kahu i devijimit për lloje të caktuara të mjeteve» |   Shenja »Parashenja për orientim të trafikut në rrugë me ndarje të shiritave të trafikut» |   Shenja »Tabela për shënimin e daljes» - tregon vendin e daljes nga autostrada ose motoudha |   Shenja »Ndalim i hyrjes së llojit të caktuar të mjeteve në autostradë ose motoudhë» |

## Tabelat plotësuese

Me shenjat e rrezikut, urdhrave të prera dhe lajmërimit mund të vendosen edhe tabelat plotësuese të cilat më hollësisht e përcaktojnë domethënien e shenjës së trafikut.

### *Lloji dhe përmbajtja e tabelës plotësuese:*

- tabela plotësuese tregon distancën ndërmjet shenjës në të cilën është e vendosur tabela plotësuese dhe fillimin e pjesës së rrugës, përkatësisht vendin me të cilin ka të bëjë shenja,







Tuneli është larg nga shenja e trafikut - 500 metra,

*Tabela plotësuese tregon distancën nga shenja deri te tuneli*

- tabela plotësues tregon gjatësinë e pjesës së rrugës në të cilën kanoset rreziku i paraparë me shenjë, përkatësisht në të cilën zbatohet urdhëri i theksuar i paraparë me shenjë, ose në të cilën është paraparë përmbajta e shenjës nga cila rrjedh tabela plotësuese,




- tabela plotësuese tregon distancën prej shenjës së objektit ose pjesës së rrugës me të cilën ka të bëjë lajmërimi,




- tabela plotësuese tregon kohën e kufizuar për të cilën vlen urdhëri i prerë,




Shenja e trafikut me tabelë plotësuese ndalon trafikun në dy kahe të lëvizjes prej 20-24h

*Tabelë plotësues*

- tabela plotësuese (E-07) përmban sqarime të shenjës me fjalë ose në ndonjë mënyrë tjetër nëse nuk është e përcaktuar qartë me simbole në shenjë,




- tabela plotësuese përmban simbole me të cilat ka të bëjë shenja,



- tabela plotësuese tregon largimin e mjetit me »Merimangë« në vendin ku ndalohet ndalja ose parkimi me rregulla apo me shenja të trafikut,



- tabela plotësuese tregon se ndalohet ndalja apo parkimi deri te shenja, prej shenjës, përkatësisht nga njëra ose tjetra anë e shenjës,




- tabela plotësuese prej tregon pozitën e parkimit të mjetit. Vendoset me shenjën parkimi,




- shenja plotësuesen tregon vendin i cili është i rezervuar për mjetet e personave me aftësi të kufizuara ose afërsinë e rrugës ku mund të paraqitet personi me aftësi të kufizuara me karrocë. Vendoset me shenjën rreziku në rrugë dhe parkimi,




- tabela plotësuese tregon vendin i cili është i rezervuar për shfrytëzuesit e veçantë. Vendoset me shenjën C-36 (parkimi),




- tabela plotësuese tregon fillimin e pjesës së rrugës, përkatësisht vendin ku ekziston rreziku nga shiu i papritur ose nga ngricat. Vendoset me shenjën rreziku në rrugë dhe kufizimi i shpejtësisë maksimale,





- tabela plotësuese tregon pozitën e rrugës me përparësi kalimi. Tabela plotësuese vendoset me shenjën rruga me përparësi kalimi.

  Tabela plotësuese vendoset me shenjën *TREKËNDËSHI* dhe *STOPI,*





- tabela plotësuese tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën mund të shfaqen personat e paaftë (të moshuarit),



- tabela plotësuese tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën mund të shfaqen personat e verbër,



Shenja E-38

- tabela plotësuese tregon e afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën bëhet pastrimi i borës. Tabela plotësuese është e përkohshme dhe vendoset gjatë kohës së kryerjes së punimeve

për mirëmbajtjen e rrugëve (pastrimin e borës),



- tabela plotësuese lajmëron se në rrugë kryhen punime të vendosjes së shenjave në rrugë,



- tabela plotësuese tregon afërsinë e vendit në rrugë ku ndodhin aksidente në komunikacion,



- tabela plotësuese lajmëron se gjatë kohës së migrimit në numër të madh të bretkosave që kalojnë përtej rrugë, paraqitet rrezik i caktuar për shoferët. Tabela plotësuese sipas rregullave vendoset me shenjën rreziku në rrugë,



- tabela plotësuese me shenjën »Dalja nga autosrada ose motoudha« - tregon afërsinë e daljes nga autoudha ose motoudha,



- shenja »shenja e nyjës së autostradës« tregon afërsinë e kryqëzimit të autostradës ose motoudhës,



- tabela plotësuese tregon kalimin për mjete transportuese me ngarkesë përtej gabariteve.



## SEMAFORËT

Domethënia e semaforit është:

- drita e kuqe nënkupton ndalim kalimin për mjete;



- drita e kuqe dhe e verdhë tregojnë se së shpejti mbaron ndalim kalimi dhe paraqitet drita e gjelbër;



- drita e gjelbër tregon kalim të lirë të mjeteve, dhe duhet të jetë e ndezur si dritë e pavarur. Kalimi nga drita e gjelbër në të verdhë, duhet të sinjalizohet me ndërprerje të dritës së gjelbër tri herë;



- drita e verdhë para dritës së kuqe nënkupton ndalimin e lëvizjes, përveç mjeteve të cilat në çastin e ndezjes së dritës së verdhë gjenden në atë largësi nga shenja e semaforit që nuk mund të ndalen në mënyrë të sigurt, e të mos e kalojnë këtë shenjë;



- shigjeta ndriçuese plotësuese (shtesë) tregon kalimin e lirë për mjete në kahun e shënuar me dritë të gjelbër edhe gjatë kohës kur është ndezur drita e kuqe ose e verdhë;



- format e shigjetave të paraqitura (shigjetat me ndriçim të kuq dhe të gjelbër),



vijat e kryqëzuara me ngjyrë të kuqe (X) tregojnë ndalimin e trafikut përgjatë shiritit të trafikut mbi të cilin është vendosur shenja,



- shigjeta e gjelbër me maje të kthyer teposhtë tregon kalim të lirë përgjatë shiritit të trafikut mbi të cilën është vendosur shenja;



- shigjeta e verdhë me maje të kthyer nga e djathta ose e majta tregon kalimin e rrjedhës së trafikut nga shiriti i trafikut mbi të cilën është e vendosur shenja në shirit tjetër.



Nëse me semaforë rregullohet trafiku i biçiklistëve në vendkalim të shtegut të biçikletave përtej rrugës, dritat në semaforë janë në formë të siluetës së biçikletës dhe kanë këto domethënie:

- kalim i lirë për biçiklistë,
- ndalim kalimi për biçiklist,
- e njëjta pajisje për dhënien e shenjave ndriçuese për biçiklistë dhe këmbësorë mund të aplikohet edhe në raste kur shigjetat e këmbësorëve dhe e biçiklistëve janë njëra pranë tjetrës.



Shenjat ndriçuese në semaforë kanë domethënien si vijon:

- kalim i lirë për këmbësorë,
- ndalim kalimi për këmbësorë.



*Shenja ndriçuese në vendkalim hekurudhor* 

- Shenjat ndriçuese në vendkalim hekurudhor paralajmërojnë ardhjen (afërsinë) e trenit gjegjësisht mbylljen e vendkalimit me mbrojtëset dhe gjysmëmbrojtëset në vendkalimet hekurudhore.

## Sinjalizimi horizonat - shenjat (shënimet) në rrugë dhe në sipërfaqe të tjera

Shenjat në rrugë janë:*shenjat në sipërfaqe të rrugës, në trotuar dhe shenjat e tjera në rrugë.*

*Vija e plotë gjatësore (ndarëse dhe anësore)*- shënon ndalim kalimin e mjeteve përtej asaj vije ose ndalim lëvizjen e mjeteve në atë vijë, përveç mjeteve që në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h, dhe mjeteve qe nuk konsiderohen automjete.




Vija gjatësore ndërprerëse dhe ndarëse e ndan sipërfaqen e rrugës në shirita të trafikut.




Vija paralajmëruese shërben për paralajmërimin e afërsisë së vijës së plotë ndarëse.




Vija e shkurtër me ndërprerje shërben si vijë udhëheqëse në kryqëzim dhe ndarje të shiritave të trafikut për mjete të transportit publik të udhëtarëve.




Vija e dyfishtë ndarëse e plotë ndalon kalimin e mjeteve mbi atë vijë ose ndalon trafikun e mjeteve nëpër atë vijë dhe aplikohet patjetër në rrugët me trafik në dy drejtime.




Vijat e dyfishta ndarëse të ndërprera shërbejnë edhe për shënimin e shiritave të trafikut me kahje të ndryshueshme të lëvizjes në të cilat trafiku drejtohet me semaforë të vendosur mbi shirita të trafikut.




Vija e dyfishtë e kombinuar shërben për ndarjen e shiritave të trafikut në vendet në të cilat kushtet e dukshmërisë janë të tilla që lejojnë tejkalimin vetëm në një kah të lëvizjes.




### *Vija e ndalimit e plotë*

Vija e e plotë e ndalimit shënon vendin ku shoferët detyrohen ta ndalin mjetin.




Vija e ndërprerë e ndalimit shënon vendin në të cilin shoferi duhet ta ndalë mjetin, por nëse është e nevojshme edhe t’i lëshojë mjetet të cilat lëvizin në rrugën me përparësi kalimi.



Vendkalimi i këmbësorëve përcakton pjesën e rrugës së destinuar për kalimin e këmbësorëve.



Kalimi i shtegut të biçiklistëve përtej rrugës është pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese e destinuar për kalimin e biçiklistëve.



Me shigjeta mund të shënohen:



- drejtime në një kah dhe dy kahe (të kombinuara);



- rreshtimi  në dy kryqëzime të afërta ku rreshtimi duhet të kryhet para kryqëzimit të parë në të cilin është i ndaluar kthimi në kahun e treguar.



*Kthimi i trafikut*



*Paralajmërimi i përfundimit të tejkalimit*

## *Pajisjet rrugore*

Pajisjet për shënimin e skajeve të rrugës janë:

- *kahu i treguesit* - shërben për shënimin  e skajit të rrugës;



- *shtyllat për borë në rrugë dhe objekte rrugore;*



- *tabelat për shënimin e ishullit* – vendosen në kryqëzime, në maje të ishullit ndarës të daljes nga
  autostrada dhe motoudha;



- *Pajisjet për njoftim mbi punimet, pengesat dhe dëmtimet në rrugë*

Tabela për shënimin e pengesave në të majtë ose në të djathtë, vendsoen në rrugë apo në objekte dhe në sipërfaqe të tjera të trafikut.



- *Tabela për shënimin e kthesës*-vendsoen në rrugë me kahjen e udhëzimit në të majtë ose në të djathtë.



- *Tabela për shënimin e kthesave të ashpra në rrugë* vendoset në vendin ku fillon kthesa e ashpër dhe e papritur;



- *Tabela e pengesës (anësore)* shënon vendin anësorë që zvogëlon profilin e rrugës.



- *Konat kufizues* shërbejnë për shënimin e punimeve në rrugë.



- *Rrethoja për shënimin e pengesave në rrugë* shërben për shënimin e pengesave në sipërfaqen e e rrugës.



- *tabela për shënimin e vendit ku kryhen punime në rrugë ose të dëmtimeve në rrugë*;



- *tabela lëvizëse me dritë vezulluese dhe shenja* - shënon vendin e punimeve në rrugë ose dëmtimin e rrugës.



## *Shenjat dhe urdhërat e policit*

Shenjat të cilat i jep personi i autorizuar (polici i trafikut), me duar dhe pozitë të trupit ose nga automjeti, për pjesëmarrësit në trafik, janë paraqitur si në vijim:



Kjo pozitë e policit nënkupton ndalim kalimin për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.







Përmes dhënies së kësaj shenje, polici i trafikut, i tregon shoferit të caktuar se duhet që të ndalë automjetin e tij për kontrollin e sigurisë. Në rrugë të hapur mund të përdoret tabela “Stop”, ndërsa në kushte të errësirës mund të përdoret bateria reflektuese.





Sipas këtyre pozitave të policit, shoferët e mjeteve që vijnë nga drejtimi në të cilin atyre iu është kthyer gjoksi ose mbrapa shpinës së policit, duhet t’i ndalojnë mjetet e tyre, ndërsa për shoferët e mjeteve që vijnë nga drejtimi i krahëve kanë të drejtën e kalimit.



Sipas kësaj pozite, të drejtën e kalimit e kanë mjetet që vijnë nga krahu i majtë i policit.



Kjo pozitë e policit nënkupton drejtimin në të cilin shoferit i jepet shenja për zvogëlim të shpejtësisë së automjetit.





Poozitë e policit do të thotë se shoferi në drejtimin e të cilit është dhënë kjo shenjë, duhet të përshpejtojë lëvizjen e automjetit.

Dora e shtrirë horizontalisht me pëllëmbë të dorës të hapur duke treguar në drejtim të një automjeti apo të kolonës së automjeteve, do të thotë se shoferi i automjetit është i detyruar ta ndalë mjetin.



*Automjeti nën përcjellje*

Drita e kuqe dhe kaltër, njëra prej të cilave është dritë e kaltër në të djathtë, dhe ngjyra e kuqe në anën e majtë të automjetit, kur ato ndizen, në kombinim me zërin e burisë me intensitet të ndryshueshëm (sipas nevojës), tregojnë se vetura e Policisë është nën përcjellje.



*Automjeti nën përcjellje*

Drita e kaltër e ndezur në automjetet zyrtare të Policisë, në kombinim me zërin e burisë me intensitet të ndryshueshëm, tregojnë automjetin me përparësi kalimi.





Në automjetet zyrtare të Policisë në pjesën e përparme dhe të pasme, mund të vendosen drita në ekranin ndriçues dhe të japin mesazhe të shkruara që janë në funksion të kontrollit dhe rregullimit të trafikut, si p.sh.:

"Stop Policia", "Liro rrugën djathtas", “Kontrollo shpejtësinë”, “Ndiqni nga mbrapa", "Ngadalëso" ... etj.

Në raste të veçanta, me qëllim të kontrollit të pjesëmarrësve në trafik, këto pajisje mund të instalohen edhe në vetura zyrtare të Policisë të cilat janë me targa civile me kusht që zyrtarët policorë gjatë detyrës me këto vetura të jenë në uniformë të rregullt zyrtare.

# 2. SHOFERI

## SHOFERI

Në vijim janë dhënë nocionet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me këtë kapitull:

***Shofer* -** pjesëmarrësi në trafik i cili e drejton mjetin rrugor;

***Shofer i ri*** **-** shofer i moshës deri në 24 vjeç, me përjashtim të shoferit i cili të drejtuarit e mjetit e ka profesion themelor;

***Shofer fillestar*** **-** shoferi i cili e ka marrë patentën e shoferit të kategorisë A, A1, A2 ose B, B1, jo më shumë se 2 vjet.

## KUJDESI DHE RAPORTI NDAJ PJESËMARRËSVE TË TJERË NË TRAFIK

Shoferi i mjetit rrugor duhet të ketë kujdes të shtuar gjatë ngasjes duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat në trafik dhe strukturën e pjesëmarrësve në trafik.



*Kujdes në trafik - fëmija me biçikletë*

Kujdesi në trafik nënkupton që shoferi me sjelljet e tij të shmangë situatat e rrezikshme të cilat do të shkaktonin një aksident.

***Në këtë situatë shoferi duhet ta ndalë veturën dhe të vëzhgojë sjelljen e fëmijës me biçikletë.***

Marrëdhënet reciproke ndaj pjesëmarrësve në trafikun rrugor njihen nëpërmjet mënyrës së komunikimit dhe mirëbesimit të tyre, që nënkupton nivel të lartë të kulturës në trafik.
Marrëdhëniet duhet të pasqyrojnë respektin e ndërsjellë, solidaritetin, besimin dhe raportin human.
Shoferi duhet të ketë mirëkuptim ndaj sjelljeve apo veprimeve të pjesëmarrësve të tjerë në trafik, edhe kur janë në kundërshtim me rregullat e sjelljes ose pasqyrojnë pasigurinë e tyre me veprime pavarësisht si këmbësorë apo si shofer i mjeteve rrugore.



*Afërsia e rrezikut - shembje gurësh*

Marrëdhëniet e ndërsjella të pjesëmarrësve në trafik vlerësohen me shkallën e kulturës në trafik dhe mirëkuptimin e tyre të ndërsjelltë.
Informacionet të cilat i merr shoferi nga sinjalizimi rrugor posaçërisht nga shenjat e rrezikut, i shërbejnë atij për të ndërmarrë masat e nevojshme varësisht nga natyra e rrezikut, në mënyrë që atë pjesë të rrugës ta kalojë sa më sigurt.

Njohuritë dhe përvoja në trafik mundësojnë zbatimin e normave pozitive të mirësjelljes, respektimin e dhe tolerancën ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

*Çdo sjellje e gabuar e cila është në kundërshtim me rregullat e trafikut dhe të sigurisë mund të shkaktojë aksident në trafik.*

Me rëndësi për shoferin gjatë ngasje është:

- *T'i kuptojë qëllimet e pjesëmarrësve të tjerë në trafik.*
- *Të dallojë çdo sjellje të gabuar të tij dhe pjesëmarrësve të tjerë në trafik;*
- *Të aplikojë ngasjen defanzive (mbrojtëse).*



*Këmbësori lëviz pranë veturës së parkuar*

Në këtë situatë vetura është parkuar jo drejtë. Këmbësori me siguri vazhdon lëvizjen në shiritin e trafikut ku jeni duke lëvizur.
Vetura vjen përball këmbësorit, i vetmi reagim i drejtë është frenimi që ia mundëson atij lëvizjen deri sa kalon pranë veturës.

*Parimet e shoferit të mirë dhe të sigurt janë:*

- ka konsideratë ndaj pjesëmarrësve tjerë në trafik që veprojn në kundërshtim me rregullat e trafikut;
- i parasheh veprimet e tij dhe të pjesëmarrëve të tjerë në trafik.



*Këmbësori lëviz në mënyrë jo të drejtë.*

***Shoferi do t'ia mundësojë këmbësorit kalimin e rrugës edhe pse ai lëviz në mënyrë jo të drejtë.***

## *KULTURA NË TRAFIK*

Kultura në trafik është element i ngritjës së sigurisë në trafikun rrugor. Me kultur në trafik kuptohet respektimi i ndërsjellë në trafik dhe toleranca ndaj pjesëmarrësve në trafik.



*Hyrja e veturës në trafik*

Sigurinë e shoferit në trafikun rrugor e karakterizon kultura dhe zotësia e parashikimit të situatës në trafikun rrugor.

*Do të mundësojë hyrjen e veturës në trafik, nëse prapa meje gjendet kolona e mjeteve rrugore.*

*Në kulturën e trafikut ndikon:*

- Personaliteti,
- Edukata familjare,
- Sjellja humane ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

## *NGASJA DEFANZIVE (MBROJTËSE)*

Ngasja është mënyra më e mirë e ngasjes për të shmangur aksidentin në trafikun rrugor.
Parimet e ngasjes defanzive janë:

- *Toleranca ndaj gabimeve të të tjerëve;*
- *Parashikimi i zhvillimit të situatave në trafik;*
- *Paralajmërimi me kohë dhe në mënyrë të qartë i pjesëmarrësve të tjerë në trafik;*
- *Respektimi i rregullave të trafikut.*

### *Shoferët e rinj dhe fillestarë*

*Shoferët e rinj dhe pa përvojë duhet të kenë parasysh:*

- si të sillen në trafik,
- të mos i mbivlerësojnë aftësitë e tyre personale,
- të mos e nënvlerësojnë rrezikun në rrugë,
- si të reagojnë në situata të rrezikshme,
- si  të reagojnë shpejtë dhe saktë, etj.

*Shkaqet që shoferët e rinj dhe pa përvojë shkaktojnë aksidente rrugore janë:*

- papërvoja në ngasje,
- mosnjohja e shkaqeve të cilat çojnë deri te aksidentet rrugore,
- mbivlerësimi i aftësive personale,
- dëshira për t'u treguar mbizotërues ndaj moshatarëve të tyre,
- ngasja nën ndikimin e alkoolit veçanërisht gjatë vikendeve.



*Shoferët e rinj në veturë*

## *Shoferët e rrezikshëm*

Shoferët që rrezikojnë sigurinë në trafik janë shoferët: agresivë, që mbivlerësojnë aftësitë e tyre, që nuk janë tolerantë ndaj gabimeve të të tjerëve, që janë nën ndikimin e alkoolit, drogës apo medikamenteve të cilat ndikojnë negativisht në aftësitë e ngasjes.
Sjelljet e rrezikshme në trafikun rrugor nënkuptojnë veprimet që mund të shkaktojnë aksidente trafiku.

Veprime që ndikojnë negativisht (rrezikojnë) sigurinë e trafikut rrugor janë:

- insistimi me çdo kusht në të drejtën e përparësisë së kalimit,
- reagimi i pamenduar dhe me vonesë,
- ngasja e ngadalshme e paarsyeshme.

## *PARASHKIMI DHE PERCEPTIMI I SITUATAVE NË TRAFIK*

Gjatë ngasjes shoferi duhet të parashikojë se çfarë mund të ndodhë në trafikun rrugor, ashtu që të jetë i përgatitur për reagim në situata të ndryshme që paraqiten në trafik.



*Parashikimi i  situatës në trafik*

Aftësia për të parashikuar qëllimet e pjesëmarrësve të tjerë në trafik është një kusht për vlerësimin dhe reagimin e saktë në situatat e trafikut.

Në situatën kur shoferi është duke e mbyllur derën  e veturës, duhet të keni parasysh se mund të dalë papritmas në rrugë, andaj duhet vëzhguar sjelljen e tij.



*Rruga me fushëpamje të kufizuar*

Aftësia për të parashikuar se çfarë mund të ndodhë pas një pjese të rrugës me fushëpamje të kufizuar ndikon në rritjen e sigurisë rrugore.
Në këtë situatë në qafë mali, ndodh që ndonjë automjet ta shfrytëzojë shiritin tuaj duke lëvizur.

*Në parashikimin e situatave në trafik ndikojnë:*

- njohuritë për rregullat e trafikut rrugor,
- përvoja në ngasje,
- çfarë mund të ndodh në një pjesë me dukshmëri të dobësuar apo me fushëpamje të kufizuar,
- njohja e rreziqeve në rrugë.

***Te perceptimi i situatës së rrezikshme në trafik më rëndësi është marrja e vendimit të drejtë dhe me kohë.***

Në perceptimin e situatës së drejtë në trafikun rrugor ndikojnë: përvoja e ngasjes, njohuritë (funksioni) për automjetin dhe njohja e rreziqeve në rrugë.



*Trotinisti lëviz jo drejtë*

Sjellja e drejtë në këtë situatë është:

- *largimi i këmbës nga gazi dhe gatishmëria për të frenuar në rast nevoje. Trotinisti mund të kalojë në shiritin e trafikut ku është duke duke lëvizur automjeti.*

Parakushtet që shoferi të marrë vendim të drejtë dhe të reagojë me kohë janë:
- *t'i njohë rregullat e trafikut,*
- *t'i parasheh veprimet e tij dhe të pjesëmarrësve të tjerë në trafik,*
- *të ketë njohuri për identifikimin e rrezikut në rrugë.*



*Lëvizja e këmbësorit në këtë situatë paraqet rrezik*

Perceptimi i drejtë te kjo situatë e rrezikshme në trafik ndikon në rritjen e sigurisë rrugore - **këmbësori mund ta kalojë rrugën.**

Sjellja e drejtë në këtë situatë është:

*Largimi i këmbës nga gazi dhe gatishmëria për të frenuar në rast nevoje. Nëse lejojnë rrethanat në trafik rritet distanca anësore e sigurisë.*

## KOHA E REAGIMIT

Pasi ta ketë vërejtur rrezikun, është shumë e rëndësishme që shoferi sa më shpejtë të reagojë në komandat e automjetit, më së shpeshti në pedalen e frenimit, për ta evituar aksidentin.

Reagim i shoferi varet nga faktorët psiko-fizikë të cilët ndikojnë negativisht tek ai.



*Shpërqendrimi në ngasje rrit rrugën e reagimit*

*Telefoni mobil - duke lexuar msm*

Procesi i reagimit është i ndarë në tri faza:

### *Vlerësimi i situatës*

Në këtë fazë, shoferi duhet të vlerësojë se çfarë po ndodh. Shoferi duhet të jetë i qetë, të mos krijojë panik, të ketë vetëbesim e të mos humbet në situata të rrezikshme në trafik.

### *Vendimmarrja*

Shoferi duhet të vendosë se cilat veprime duhet t'i ndërmarrë që të mos shkaktohet aksidenti.

### *Veprimi*

Shoferi reagon me veprim që, sipas gjykimit të tij, është më i përshtatshëm në situatën konkrete të trafikut për ta evituar aksidentin.

Koha e reagimit varet nga:

- *lloji i ngacmimit (drita, zëri, prekja, etj.) te shoferi,*
- *aftësitë personale të shoferit,*
- *gjendja psikofizike e shoferit (sëmundja, lodhja, alkooli, barnat e ndaluara, etj.),*
- *niveli i njohurive dhe shkathtësive të ngasjes,*
- *mosha e shoferit.*

Koha e reagimit për çdo shofer është e ndryshme.

***Koha mesatare e reagimit të shoferit është një sekondë***

Koha e reagimit zgjatet te shoferët që janë nën ndikimin e alkoolit, drogës dhe barnave të cilat ndikojnë negativisht në aftësitë psiko-fizike, nga moskujdesi, lodhja, përdorimi i telefonit me duar, mospërqendrimi në ngasje, etj.
Prandaj, është e rëndësishme për shoferin që gjatë ngasjes të parashikojë rreziqet e papritura, të marrë vendimet e duhura dhe të reagojë në kohë të duhur dhe të saktë.

## *Sjellja e shoferit nën ndikimit e alkoolit, drogës dhe barnave*

Alkooli ndikon negativisht te aftësia e shoferit gjatë ngasjes:

- *zgjat kohën e reagimit,*
- *zvogëlon fushën e dukshmërisë,*
- *zvogëlon aftësinë për ngasje.*

Alkooli te shoferi ndikon negativisht:

- *mbivlerësim i aftësive të tij personale,*
- *vlerësim jo i drejtë i situatave në trafik,*
- *reagim shumë i ngadalshëm,*
- *rritje e vetëbesimit,*
- *nxitje e dëshirës për shpejtësi të madhe.*

Gabimet më të shpeshta të shoferit nën ndikimin e alkoolit janë:

- *mosrespektimi i shpejtësisë së lejuar,*
- *tejkalimet jo të rregullta,*
- *mosrespektimi i përparësisë së kalimit.*

*Alkooli reagon më shpejtë te shoferi nëse:*

- *është i lodhur,*
- *konsumon alkool në lukth të zbrazët,*
- *është në stresë, nervozë, etj.*

Narkotikët (drogat e ndryshme) ndikojnë negativisht në aftësitë e shoferit:

- *vlerësimi jo drejtë i situatave në trafik,*
- *nxitja e dëshirës për tejkalim,*
- *zvogëlimi i aftësive për t'i vlerësuar situatat në trafik në mënyrë të drejtë.*

## *Gjendja psikofizike dhe lodhja e shoferit*

Faktorë që ndikojnë negativisht (zvogëlojnë aftësinë për ngasje) në gjendjen psikofizike të shoferit:

- *sëmundjet akute dhe kronike,*
- *ushqyerja jo e rregullt,*
- *alkooli,*
- *lodhja,*
- *zhurma dhe vibracionet,*
- *klima e papërshtatshme,*
- *temperaturat e larta / ulëta në kabinën e shoferit,*
- *pagjumësia, etj.*

***Lodhja gjatë ngasjes paraqitet gradualisht.***

## *Medikamentet (barnat)*




*Ndikim negativ te shoferi kanë medikamentet (barnat) që nuk lejohen të përdoren para ose gjatë ngasjes sepse zvogëlojnë aftësinë për ngasje.*

*Faktorët që shkaktojnë lodhjen e shoferit dhe zvogëlojn aftësinë për ngasje janë:*

- ushqimi jo i rregullt,
- vibracionet (dridhjet) e mjetit,
- zhurma.

*Nëse shoferi ndihet i lodhur gjatë ngasjes natën duhet ta parkojë mjetin dhe të pushojë.*



*Pirja e duhanit paraqet rrezik në trafik*

Pirja e duhanit gjatë ngasjes ndikon negativisht:

- *krijon Monoksidin e karbonit (CO),*
- *dobëson përqendrimin,*
- *gjatë ndezjes së cigares mund të shkaktohen gabime,*
- *zvogëlon përqëndrimin në ngasje,*

*-zZvogëlon aftësinë për ngasje.*

***Lodhja gjatë ngasjes në relacione të gjata evitohet me pushim.***

# 3. RRUGA

## RRUGA

Rruga është faktor i sigurisë bazë në trafikun rrugor. Nëse rruga është e ndërtuar mirë sipas standardeve dhe e pajisur me sinjalizim (rrugë sipas standardeve) do të ndikojë në zvogëlimin e aksidenteve rrugore.

*Termat (nocionet) e përdorua në këtë kapitull kanë këtë kuptim:*

***Rrugë e pashtruar / rrugë dheu*** **-** rrugë pa sipërfaqe të ndërtuar rrugore dhe pa shtresë rruge, e cila as edhe në pikën e lidhjes me rrugën publike nuk ka sipërfaqe të ndërtuar rruge;

***Rrugë qarkulluese*** **-** pjesa e sipërfaqes rrugore që shërben në rend të parë për lëvizje të mjeteve rrugore;

***Vendkalim hekurudhor*** **-** pjesa e rrugës e cila kalon përtej binarëve hekurudhorë ose të tramvajit në të njëjtin nivel, e cila mund të jetë e siguruar fizikisht me mbrojtëse dhe gjysmë mbrojtëse, me shenja të trafikut apo e pasiguruar;

***Vendkalim për këmbësorë*** **-** pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese që shërben për kalim të këmbësorëve nëpër këtë shtresë, e cila është shënjuar me shenja përkatëse;

***Vendkalim për biçikleta*** **-** pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese që shërben për kalim të biçikletave dhe të mjeteve të tjera që lëvizin nëpër shiritin apo shtegun e biçikletave, e cila është e shënjuar me shenja përkatëse;

***Vendndalim i autobusit*** **-** pjesa e një sipërfaqeje të rrugës që shërben për ndalje të autobusëve me qëllim që të hyjnë dhe të dalin udhëtarët dhe që është e shënuar me shenjë përkatëse të trafikut;

***Zonë e këmbësorëve*** **-** sipërfaqe e ndërtuar e trafikut që shërben në rend të parë për lëvizje të këmbësorëve, në të cilën iu ndalohet lëvizja mjeteve me veprim motorik, përveç atyre me leje të veçantë;

***Zonë e shkollës*** **-** pjesa e rrugës apo rrugë lagjeje, e cila gjendet në afërsi të shkollës dhe e cila duhet të jetë e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut;

***Zonë e trafikut të qetë*** **-** zonë në një qendër të banuar, e shënuar me shenjë përkatëse të trafikut, në të cilën mjetet nuk duhet të lëvizin me shpejtësi më të madhe se lëvizja e këmbësorit dhe në të cilën lojërat për fëmijë janë të lejuara në tërë zonën;

### *Karakateristikat e rrugës*

***Lloji i sipërfaqes së rrugës*** **-** rruga mund të jetë me sipërfaqe të ndërtuar (asfalt, beton, etj,) ose pa te (makadam, zhavorr, rërë, tokë).

Puthitja e gomave varet nga lloji i rrugës e cila mund të jetë e vrazhdë ose e lëmuar. Sipërfaqja e rrugës e vrazhdë është më e favorshme se ajo e lëmuar për shkak se puthitja e gomave me rrugën është më e mirë, dhe kushtet e frenimit janë më të mira.

## *Gjendja e sipërfaqes së rrugës*

Gjendja e rrugës varet mbi të gjitha nga kushtet e motit**,** që nënkupton se sipërfaqja e rrugës mund të jetë e thatë dhe e pastër, e ndotur, me rërë, zhavorr, e lagësht, me baltë, mbuluar me gjethe, me borë, e ngrirë -akull, etj. Në rrugë mund të gjendet pluhur, vaj, mbeturina gomash etj.



Kjo gjendje e rrugës zgjatë rrugën e frenimit.

*Rruga e mbuluar me gjethe*

Gjendja e sipërfaqes së rrugës ndikon në puthitjen e gomave, gjatësinë e rrugës së frenimit dhe mënyrën e drejtimit të mjetit.



Gjatë kohës me shi, borë, akull, rruga bëhet e rrëshqitshme**.**

*Kushtet atmosferike me shi*

Në rrugë të ashtuquajtura vrima goditëse paraqesin rrezik në veti edhe te shpejtësitë e vogla, duke u shkaktuar dëme automjeteve në pneumatikë dhe në sistemin e varjes, sidomos gjatë kohës me shi ku ato mbulohen me ujë.



***Fushëpamje e kufizuar***" - hapësira e kufizuar të cilën pjesëmarrësi në trafik mund ta shohë nga vendi ku gjendet, për shkak të rrugës me kthesa të padukshme, me kurrize apo për shkak të ndonjë pengese fizike, të ndonjë objekti apo të ngjashme.

.

*Fushëpamje e kufizuar*



*Fushëpamje e mirë e rrugës*

Rruga me sinjalizim rrugor rrit sigurinë në trafikun rrugor.



*Kthesë e rrezikshme majtas*

Pjesët e rrugës me kthesa apo kurriz rruge paraqesin rrezik për shoferët e rinj, fillestarë dhe ata pa përvojë.

Në kthesa mund të jetë pashmëria e kufizuar dhe ndikon forca centrifugale e cila tenton që ta largojë automjetin jashtë rrugës.

***Ngasja në pjerrtësi gjatësore paraqet pjesën e rrugës së rrezikshme, sideomos nëse ajo është rrëshqitshme, ndalja dhe nisja paraqesin probleme tëmëdha për shoferët e rinj, fillestarë dhe ata pa përvojë.***

## *Rruga e drejtë*

Ngasja në rrugë të drejtë dhe të gjatë mund të jetëe e rrezikshme:



*Rruga e drejtë*

- *monotonia dhe lodhja shfaqen më shpejtë,*
- *rritja e dëshirës për tejkalime dhe shpejtësi të mëdha,*
- *humbja e kontrollit mbi shpejtësinë e lëvizjes,*
- *mundësia e çuarjes në verbim nga dritat e automjeteve - natën, gjatë përballkalimit.*

## FORCAT QË NDIKOJNË NË AUTOMJET

Gjatë ngasjes së automjetit ndikojnë forca të ndryshme të cilat e pengojnë apo e ndihmojnë ngasjen:

- ***force tërheqëse*** - për të lëvizur automjeti, motori duhet të siguroë forcën tërheqëse dhe puthitja e gomave me rrugën duhet të jetë e mirë.
- ***forca centrifugale*** - shfaqet gjatë ngasjes nëpër kthesa.
- ***forca e frenimit*** - është forca që shfaqet si rezultat i ngasjes në përpjetëze, erës, fërkimit, etj.
- ***forca e fërkimit*** - për të nisur automjetin nga vendi, forca e fërkimit duhet të jetë më e madhe se forca tërheqëse, në kundërten, rrotat e automjetit rrotullohen në vend.
- ***forca anësore*** - shfaqet gjatë erërave të mëdha anësore.



*Forca centrifugale*

***Forca centrifugale vepron në automjet gjatë ngasjes nëpër kthesa, sa më e madhe shpejtësia dhe sa më e vogël rrezja e kthesës, ndikimi i forcës centrifugale është më i madh.***

## RRUGA E NDALJES

***Shoferi duhet të lëvizë me atë shpejtësi që ndalë mjetin para çdo pengese e cila mund të paraqitet në rrugë.***

***Rruga e reagimit - ka të bëjë me shoferin i cili e ka vërejtur rrezikun dhe merr vendim për të frenuar d.m.th me shtyp pedale.***

***Rruga e reagimit varet nga kushtet psiko-fizike të shoferit dhe faktorët që ndikojnë në to.***

***Sa më shumë vanohet shoferit për ta shtypur pedaljen e frenimit aq më i madh do të jetë rreziku për të shkaktuar një aksident.***

***Rruga e frenimit - fillon nga çasti i shtypjes së pedales së frenit punues (këmbës) dhe zgjat deri në ndalje të mjetit.***

Rruga e frenimit varet nga :

- *shpejtësia e lëvizjes,*
- *lloji dhe gjendja e rrugës,*
- *kushtet atmosferike,*
- *ngarkesa në mje,*
- *lloji dhe gjendja e pneumatikëve,*
- *loji dhe gjendja e sistemit frenues, etj.*

Si llogaritet rruga e reagimit?
Te shpejtësia e lëvizjës 50 km/h, rruga e reagimit është Sr=15 m. (50 km/h : 10) x 3 = 15 metra
Si llogaritet rruga e frenimit?
Te shpejtësia e lëvizjës 50 km/h, rruga e frenimit është Sf=25 m. (50 km/h :10) x (50 km/h :10) = 25 metra.
Si llogaritet rruga e ndaljes së mjetit? Sr=15 m+ Sf=15 m= 40m.



*Nëse rruga është e rrëshqitshme (shi, borë, akull, baltë, fletë, mjegull, yndyra vaji, etj) rritet rruga e frenimit.*

*Rruga e mbuluar me borë*

*Nëse shpejtësia e lëvizjes dyfishohet, rruga e frenimit zgjatet katër herë.*



*Pneumatikët me presion të rregullt sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe me sharra të përparme ndikojnë në zvogëlimin e rrugës së frenimit.*

Aksidenti mund të evitohet pas vërejtjes së rrezikut:

*-me frenim,*
*-me kthim të mjetit djathtas ose majtas,*
*-me nxitim,*
*-me shenja akustike.*

*Pneumatikët*

# 4. PJESËMARRËSIT E TJERË NË TRAFIK

## DISPOZITAT PËR LËVIZJE TË KËMBËSORËVE

Këmbësori duhet të lëvizë në sipëfaqe të dedikuar për këmbësorë. Në rrugën qarkulluese këmbësorit nuk i lejohet lëvizja, ndalja apo lojërat dhe lëvizja me pajisje të ndryshme etj. Nëse këmbësori është i detyruar të lëvizë në shiritin e trafikut, duhet të lëvizë sa më afër cepit të djathtë, duke mos e penguar dhe rrezikuar lëvizjen e mjeteve rrugore.

### *Kalimi i rrugës nga ana e këmbësorëve*

Këmbësori gjatë kalimit të rrugës obligohet që të ketë kujdes të posaçëm dhe gjithherë ta shfrytëzojë vendkalimin e këmbësorëve atëherë kur ai ekziston.



*Vendkalimi për këmbësorë*

Këmbësori është i detyruar ta kalojë rrugën qarkulluese, shiritin ose shtegun për biçikleta me kujdes të shtuar duke kaluar rrugës më të shkurtër dhe duke u vërtetuar para se ta fillojë kalimin e rrugës se këtë mund ta bëjë në mënyrë të sigurt.

Gjatë kalimit të rrugës, të shiritit apo të shtegut të biçikletave ose të binarëve, këmbësorit nuk i lejohet përdorimi i telefonit mobil, shfrytëzimi i dëgjueseve në veshë apo i pajisjeve të tjera të ngjashme që mund ta hutojnë.

### *Vendkalim i këmbësorëve*



*Kalimi i rrugës jashtë vendkalimit për këmbësorë*

Në rrugë e cila ka vendkalim të këmbësorëve ose kalime të veçanta të ndërtuara për këmbësorë, këmbësori është i detyruar të lëvizë nëpër këto kalime, nëse ato nuk janë të larguara nga ai më shumë se 50 metra brenda vendbanimit.

Kalimi i rrugës jashtë vendkalimit të këmbësorëve lejohet vetëm nëse nuk e pengon lëvizjen e mjeteve.

## Lëvizje jashtë vendbanimit



*Lëvizja në kundërshtim me rregullat e trafikut*

Këmbësori i cili ec në rrugë jashtë vendbanimit duhet ta shfrytëzojë anën e majtë të rrugës në kah të lëvizjes dhe gjatë kohës së pashmërisë së zvogëluar ta mbajë ndonjë mjet ose pajisje reflektuese apo burim drite, si: jelek reflektues, rroba reflektuese, bateri e të ngjashme.
Këmbësorit i lejohet lëvizja pranë skajit të djathtë të rrugës vetëm nëse lëvizja është më e sigurt për të, si: kthesë e padukshme, humnerë, vend i gërmuar, shembje gurësh apo të ngjashme.

Këmbësori i cilli e kalon rrugën jashtë vendkalimit obligohet që t'u japë përparësi mjeteve dhe ta kalojë rrugën duke e shfrytëzuar rrugën më të shkurtër, nën kënd të drejtë me vijën e mesit të rrugës



*Kalimi i rrugës jashtë vendbanimit*

Në rrugë e cila ka vendkalim të këmbësorëve ose kalime të veçanta të ndërtuara për këmbësorë, këmbësori është i detyruar të lëvizë nëpër këto kalime, nëse ato nuk janë të larguara nga ai më shumë se 100 metra jashtë vendbanimit.

## Sjellja e këmbësorëve në vendkalim

Në vendkalimin e shënuar për këmbësorë në të cilin qarkullimi i këmbësorëve nuk rregullohet me semaforë as me shenja të personit të autorizuar, këmbësori edhe pse ka përparësi kalimi, duhet t'i kushtojë kujdes largësisë dhe shpejtësisë së mjetit i cili i afrohet.

## Kolona e organizuar e këmbësorëve



*Lëvizja e kolonës së organizuar të këmbësorëve*

*Kolonës së organizuar të këmbësorëve i lejohet të lëvizë vetëm në anën e djathtë të rrugës në kah të lëvizjes.*

## *Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve*




*Kalimi i rrugë nga këmbësorët*

Gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësorë, shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të shtuar dhe t'i japë përparësi këmbësorit i cili është në vendkalim ose hyn në të.

Në qoftë se trafiku në vendkalimin e shënuar për këmbësorë është i rregulluar me semaforë ose me shenja të personit të autorizuar, duhet të veprojë sipas rregullave të parapara.



*Kthimi djathtas – vendkalimi në hyrje të rrugës*

Nëse vendkalimi i shënuar për këmbësorë gjendet në hyrje të rrugës, shoferi i cili lëviz në atë rrugë është i detyruar të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe t'i lëshojë të kalojnë këmbësorët të cilët gjenden ose hyjnë në vendkalim dhe, sipas nevojës, ta ndalë mjetin e vet për t'i lëshuar këmbësorët.



*Hyrja e veturës në rrugën qarkulluese*

*Gjatë kalimit nëpër trotuar apo nëpër shteg të këmbësorëve, shoferi i mjetit duhet të drejtojë ngadalë dhe t'iu japë përparësi këmbësorëve.*

Shoferit i veturës duhet t'i jap përparësi kalimi këmbësorëve që lëvizin nëpër trotuar.



*Këmbësori ka përparësi kalimi*

Shoferi i cili me mjet kthehet në rrugë anësore, në hyrje të së cilës nuk ekziston vendkalim i shënuar për këmbësorë, është i obliguar të kthehet me shpejtësi të zvogëluar dhe nuk i lejohet t'i rrezikojë këmbësorët të cilët tashmë kanë hyrë në rrugë.

## *Kujdesi i shoferit ndaj pjesëmarrësve të veçantë*

Në rastin kur rruga kalohet nga persona me aftësi të kufizuara, nga persona të moshuar, nga personat e verbër, ose nga fëmijët, shoferi detyrohet ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ua mundësojë atyre personave që ta kalojnë rrugën.



*Personi i moshuar duke kaluar rrugën*

## *Pjesëmarrja në trafik e personit të verbër*



*Personi i vebër duke kaluar rrugën*

Kur personi i verbër merr pjesë në trafik pa praninë e personit përcjellës, ai duhet ta mbajë si shenjë identifikimi shkopin e bardhë, ose një shenjë dalluese, ose të jetë nën përcjellje të qenit të aftësuar për udhëheqje.

Shoferi e ka për detyrë të ketë kujdes të veçantë ndaj personave të verbër.



Mjeti i cili është i përshtatur për t'u drejtuar nga personi me aftësi të kufizuara, me kërkesë të tij mund të shënohet me shenjë të veçantë.

## *Siguria e fëmijëve në rrugë*

Shoferi është i detyruar që të ketë kujdes ndaj fëmijëve në rrugë pasi janë pjesëmarrës të rrezikuar në trafikun rrugor dhe nuk vlen parimi i besimit ndaj tyre.
Fëmijët nuk i njohin rregullat e trafikut, veprojnë spontanisht, pa parashikim, nuk i njohin rreziqet në rrugë, etj.



Fëmijët në trafik, nuk janë të vetëdijshëm për rrezikun dhe mund të mos vërehen nga shoferët e automjeteve.

Në këtë situatë lëvizja në mes të veturave të parkuara dhe dalja e fëmijës në shirtin e trafikut mund të mos vërehet me kohë nga shoferët e automjeteve dhe mund të rrezikohet siguria e tij.

*Lëvizja e fëmijës në mes të veturave të parkuara*



*Mosvështrimi i trafikut nga ana e fëmijës-biçikklistit*

Në këtë situatë fëmija mund të veprojë spontanisht pa parashkim duke hyrë në rrugën qarkulluese, pa e vërejtur automjetin.

Ju duhet ta largoni këmbën nga pedalja e gazit (të mos i jepni gaz dhe të jeni të gatshëm në rast nevoje për frenim) duke vëzhguar sjelljen e biçiklistit.



*Mosvështrimi i trafikut nga ana e fëmijës*

Në shumicën e rasteve këmbësorët nuk shikojnë dy anët e rrugës duke rrezikuar vetën dhe shoferin e automjetit. Prandaj, shoferi gjithnjë në rast nevoje duhet të jetë i përgatitur të reagojë, pasi që veprimet e fëmijëve janë të paparashikueshme.

Shoferi duhet ta largojë këmbën nga pedalja e gasit (të mos i jep gaz dhe në rast nevoje të jetë i gatshëm për frenim), nëse këmbësori hyn në rrugë.



*Fëmijët mund të vrapojnë pas topit*

Nëse topi rrokulliset para automjetit, shoferi duhet ta zvogëlojë shpejtësinë dhe të jetë i gatshëm për frenim, pasi që fëmijët mund të vrapojnë pas topit.

# 5. RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE RREGULLORET

## RREGULLAT E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR NGASJEN E AUTOMJETIT

Shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet t'i mbajë me vete dokumentet zyrtare si në vijim:

- *patentën e shoferit,*
- *certifikatën e regjistrimit të automjetit,*
- *autorizimin, nëse mjeti shfrytëzohet për drejtim jashtë vendit, shoferi nuk është pronar i mjetit ose pronari i mjetit nuk është në mjet,*
- *policën e sigurimit,*
- *raportin evropian të aksidenteve.*

## FAKTORËT E SIGURISË QË KANË TË BËJNË ME MJETIN, TRANSPORTIN E PERSONAVE DHE NGARKESËN

### Transporti i personave

Në mjet lejohet të transportohen vetëm aq persona sa ka ulëse të montuara në mjet, përkatësisht sa janë të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit.



*Fëmijët në veturë*

*Dy fëmijë nën moshën 10 vjeçe konsiderohen si një person i rritur.*

Shoferit të mjetit nuk i lejohet që në ulëset e para ta bartë personin i cili është nën ndikim të alkoolit, të drogave apo të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike.

### Sjellja e udhëtarëve ndaj shoferit

Gjatë drejtimit të mjetit nuk lejohet pengimi i shoferit nga persona që gjenden në mjet, në atë mënyrë që do të rrezikohej siguria në trafik.

Nuk iu lejohet personave t'i hapin dyert e mjetit pa lejen e shoferit të mjetit i cili është i ndalur.

Nëse derën e mjetit që transporton udhëtarë e hap personi i mitur, përgjegjësinë për këtë e mban shoferi, ndërsa nëse derën e mjetit e hap personi i moshës madhore, përgjegjësinë për këtë e mban vetë personi.

### Sjellja e udhëtarëve gjatë lëvizjes së mjetit

Gjatë kohës së lëvizjes së mjetit nuk lejohet që personat të kërcejnë, t'i hapin dyert, të dalin me pjesë të trupit jashtë mjetit, të ulen në dritare apo të ngjashme, në pjesë të jashtme të mjetit ose në mjete të bashkëngjitura.

### *Ngarkesa në mjet*

Mjeti që ndodhet në trafikun rrugor ndalohet të ngarkohet më tepër se masa më e madhe e lejuar, e përcaktuar në certifikatën e regjistrimit të mjetit, ta tejkalojë ngarkesën boshtore të lejuar ose t'i tejkalojë mundësitë teknike të rrugës.

Ngarkesa në mjet duhet të vendoset dhe, sipas nevojës të përforcohet e të mbulohet, në atë mënyrë që:

- *të mos e rrezikojë sigurinë e pjesëmarrësve në trafik,*
- *të mos i dëmtojë rrugët dhe objektet në rrugë,*
- *të mos e dobësojë stabilitetin e mjetit dhe të mos e vështirësojë drejtimin e mjetit,*
- *të mos ia zvogëlojë shoferit të mjetit pamjen e rrugës,*
- *të mos krijojë zhurmë të tepërt,*
- *të mos derdhet a të mos shpërndahet nëpër rrugë,*
- *të mos i mbulojë pajisjet dhe sinjalet ndriçuese në mjet,*
- *të mos i mbulojë targat e regjistrimit dhe shenjat e tjera të përcaktuara të mjetit.*

### *Shënimi i ngarkesës në mjet*

Ndalohet që ngarkesa në mjet të kalojë më tepër se 1 metër në pjesën e përparme.




*Ngarkesa në veturë*




Nëse ngarkesa e kalon pjesën e pasme më të skajshme të mjetit më tepër se 1 m, shënohet me pëlhurë të kuqe.

*Shënimi i ngarkesa në veturë*

### *Shënimi i ngarkesës gjatë dukshmërisë së vështirësuar*

Gjatë kohës së dukshmërisë së vështirësuar, pikat më të skajshme të ngarkesës që transportohen në mjet duhet të shënohen: me dritë ose me materie me ngjyrë ose materie reflektuese, me dritë apo me materie reflektuese të cilat nga ana e përparme japin dritë të bardhë, kurse nga ana e pasme dritë të kuqe, në rastin kur ngarkesa në mjetin rrugor ose në rimorkio kalon anash cepin e jashtëm të dritës së përparme ose të pasme për shënim të mjetit më tepër se sa parashihet me rregullat e parapara.

## *SJELLJA NË RAST AKSIDENTI TË TRAFIKUT*

Personi i cili gjendet ose has në vendngjarje të aksidentit të trafikut në të cilin ka persona të lënduar, duke i pasur parasysh njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e veta, duhet t'iu japë ndihmë personave të lënduar në aksident dhe, sipas mundësisë, t'i bartë ata deri te institucioni më i afërm shëndetësor, si dhe

t'i marrë të gjitha masat në mënyrë që të parandalojë rreziqe të reja, për aq sa është kjo e mundur.Personi e ka për detyrë që ta informojë menjëherë Policinë dhe institucionet shëndetësore.

### Sjella e pjesëmarrësit në aksident të trafikut



*Aksident trafiku*

Shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi tjetër i përfshirë në aksident të trafikut në të cilin dikush e ka humbur jetën, ose është lënduar, ose është shkaktuar dëm i madh material, e ka për detyrë:

- ta ndalë mjetin, nëse është me mjet, dhe të qëndrojë në vendin e aksidentit të trafikut. Përjashtim bëjnë rastet kur pjesëmarrësi në aksident iu ofron ndihmë personave të lënduar, ose në qoftë se vetë atij i nevojitet ndihma mjekësore, ose nëse është larguar për ta njoftuar policinë, me kusht që të kthehet në vendin e aksidentit sapo të jetë kjo e mundur;

- të ndërmarrë gjithçka që është e mundur, në mënyrë që të mënjanohen rreziqe të reja,të mundësohet rrjedha normale e trafikut, të bëhen përpjekje që të mos ndërrohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese, me kushtin që ndërmarrja e atyre masave të mos e rrezikojë sigurinë e trafikut;

- ta njoftojë Policinë për aksidentin e trafikut, dhe ta presë ardhjen e personave të autorizuar të cilët e bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit.

Personi i cili është njoftuar për aksidentin e trafikut në të cilin është lënduar ndonjë person, e ka për detyrë që t'i njoftojë menjëherë institucionet shëndetësore dhe Policinë.

### Aksidenti me dëme të vogla materiale



Shoferët - pjesëmarrës në aksident të trafikut në të cilin është shkaktuar dëm i vogël material janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë mjetet nga shiriti rrugor, që ta mundësojnë qarkullimin e papenguar të trafikut dhe ta plotësojnë e ta nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve.

Shoferët pjesëmarrës në aksident trafiku e plotësojnë dhe e nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve vetëm kur pajtohen për mënyrën se si ka ndodhur aksidenti.

Raporti evropian i aksidenteve nuk plotësohet dhe nuk nënshkruhet në rastin e aksidentit në të cilin ka persona të lënduar ose të vdekur.

*Raporti Evropian i Aksidenteve*

### Obligimet e shoferit ndaj të lënduarve në aksident

Shoferi i cili ka qenë ose has në vendin e aksidentit të trafikut, por i cili nuk është i përfshirë në aksident, e ka për detyrë që me kërkesë të personit të autorizuar ta dërgojë personin që është lënduar në

aksident të trafikut deri në institucionin më të afërt shëndetësor, njëjet vepron edhe nëse nuk ka urdhër nga polici, përveç në qoftë se ka ndodhur aksidenti në vendin në të cilin mund të pritet ardhja e shpejtë e mjetit të ndihmës së shpejtë, apo në qoftë se shoferi konstaton se me mënyrën jo profesionale dhe jo përkatëse gjatë transportit gjendja e personit të lënduar mund të përkeqësohet.



*Pajisjet rezrevë për veturë*

### *PAJISJET REZERVË DHE SHTESË TË AUTOMJETIT*

Vetura në trafikun rrugor duhet t'i posedojë pajisjet rezervë dhe shtesë: kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues. Të gjitha këto pajisje duhet të jenë të kompletuara.

## *KUSHTET PËR DREJTIMIN E MJETIT*

Mjetin me veprim motorik në trafikun rrugor mund ta drejtojë në mënyrë të pavarur vetëm personi i cili posedon patentë shoferi të vlefshme vendore ose të një vendi të huaj.

Shoferi ka të drejtë t'i drejtojë vetëm ato kategori të mjeteve të cilat i ka të shënuara në patentën e vet të shoferit.



*Shkrimi i msm në telefonin e dorës (mobil)*

Shoferi gjatë kohës së drejtimit të mjetit me veprim motorik duhet t'i shfrytëzojë mjetet ndihmëse të cilat i ka të shënuara në patentën e vet të shoferit.
Shoferit të mjetit me veprim motorik gjatë kohës së drejtimit nuk i lejohet përdorimi i telefonit të dorës – mobil, as i pajisjeve të tjera të cilat do ta zvogëlonin mundësinë e reagimit dhe drejtimit të sigurt të mjetit. Këto pajisje mund të shfrytëzohen gjatë drejtimit të mjetit nëse përdorimi i tyre bëhet pa i mbajtur me dorë.

### *Kushtet psikofizike për drejtim të mjetit*

Shoferi i cili e drejton mjetin në trafikun rrugor duhet të jetë i aftë në pikëpamje fizike dhe psikike për ta drejtuar mjetin dhe për këtë të ketë njohuri dhe shkathtësi të nevojshme.

Ndalohet ta drejtojë mjetin shoferi që është i lodhur, i sëmurë ose që ndodhet në gjendje të tillë psikike saqë është i paaftë për ta drejtuar mjetin në mënyrë të sigurt, si dhe shoferi që është nën ndikim të narkotikëve, barnave dhe substancave në udhëzimin e të cilave është e shënuar se ndalohet përdorimi i tyre para ose gjatë kohës së drejtimit të mjetit.

## *Ndalimi i përdorimit të alkoolit*

Shoferit të ri dhe fillestar, nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në trafikun rrugor nëse ka alkool në organizëm.



*Testi i alkoolit*

Shoferit të mjeteve të kategorisë B1, B, BE, T, dhe L nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në trafikun rrugor nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë.

# 6. RREGULLAT E VEÇANTA DHE KUJDESI GJATË DALJES NGA AUTOMJETI



## RREGULLAT  E VEÇANTA - DALJA NGA AUTOMJETI

Në mjetin e ndalur ose të parkuar nuk lejohet hapja e dyerve, nëse me këtë pengohet lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë në trafik ose rrezikohet siguria në trafik.



*Hapja e derës së veturës në mënyrë jo të rregullt*

Nga pakujdesia e shoferit të veturës është rrezikuar biçiklisti.
Shoferi gjatë hapjes së derës nuk ka shikuar në pasqyrë dhe as këndin e vdekur ku si pasojë ka ardhur deri te kjo situatë në trafik.

Shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të shtuar gjatë daljes së udhëtarëve nga mjeti, posaçërisht fëmijëve, ashtu që dalja të bëhet nga ana ku nuk lëvizin mjetet, nga ana e trotuarit apo të ngjashme.
Nuk lejohet hapja e derës nga asnjë person derisa automjeti është në lëvizje dhe as largimi nga mjeti kur motori është i ndezur.

### Detyrimet e shoferit para se të largohet nga mjeti

Para se të largohet nga mjeti, shoferi i cili e lë mjetin në rrugë është i detyruar t'i marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që mjeti mos të lëvizë vetë nga vendi ose që personat e paautorizuar të vënë atë në lëvizje: të fiket motori, të mbyllen dritaret dhe dyert, çelësat t'i marrë me veti ose të ngjashme.

### *Këndi i vdekur - ang.* BLIND SPOT *(shikimi mbi supe)*

Këndi i vdekur paraqitet te pjesët anësore dhe të prapme të veturës, gjatë ngasjes nuk shihet automjeti i cili gjendet në këtë zonë me anë të pasqyrave, andaj duhet shikuar mbi supe - me kthim koke majtas /d jathtas për të shikuar se mos ka ndonjë automjet në zonën e këndit të vdekur.



*Këndi i vdekur në veturë – me ngjyrë të kuqe*

***Shoferit nuk i lejohet të bëjë asnjë veprim pa e shikuar këndin e vdekur, pasi që mund të jetë ndonjë mjet rrugor në këtë zonë dhe mund të shkaktohet aksidenti.***

Automjetet e reja janë pajisura me sistem inteligjent të ashtuquajtur *"Blind Spot Assist"*, p. sh. i Mercedes-it, mund të aktivizojë edhe frenat për të shmangur një aksident. Më saktësisht, ESP-i do të reagojë duke frenuar rrotat në njërën anë, duke parandaluar ose ngadalësuar kalimin në shiritin tjetër të trafikut.

Në rrugë me tre shirita trafiku për një kahe kur shoferi është duke lëvizur në shiritin e mesëm e do që ta ndërrojë shiritin e trafikut djathtas apo majtas, pajisjet inteligjente i'a lehtësojnë një veprim të tillë, dhe nëse ka ndonjë automjet në zonën e këndit të vdekur e detektojnë atë dhe e sinjalizojnë shoferin.

Në fotot e mëposhtme është paraqitur radhitja e veprimeve para se të ndërmerret ndonjë veprim me automjet.




*Radhitja e veprimeve para se të ndërmerret ndonjë veprim në trafik*

1. Shikimi në pasqyrën e brendshme.
2. Shikimi në pasqyrën e jashtme.
3. Shikimi në këndin e vdekur.
4. Dhënia e treguesve të drejtimit.

## *Bllokimi i vendkalimeve*

Shoferit nuk i lejohet të ndalet në vendkalim të shënuar për këmbësorë, biçiklistë, hekurudha, etj, nëse trafiku është i dendur paraprakisht duhet të planifikojë ngasjen, se a ka hapësirë të mjaftueshme prapa vendkalimit të tillë, nëse trafiku është bllokuar.



*Ndalja e veturës jo në rregull*

Vetura nuk ka drejtë të ndalet në vendkalim të këmbësorëve, duke penguar lëvizjen e këmbësorëve.

## Shpërqendrimi gjatë ngasjes

Shoferit nuk i lejohet që të shpërqendrohet gjatë ngasjes sepse mund të mos i vërejë situatat e rrezikshme dhe të reagojë me vonesë në evitimin e rrezikut në rrugë.

Shpërqendrimi gjatë ngasjes mund të jetë si pasojë e stresit, ngarkesës psikike, zemërimit, bisedave me bashkëudhëtarë, ngrënies së ushqimit, ndërrimit të pajisjeve në aparat (radio, CD, etj.), dëgjimit të muzikës më zë të lartë, përdorimit të telefonit të dorës, pajisjeve të ndryshme audiotive, etj.

Shumica e aksidenteve në trafikun rrugor ndodhin për shkak të përdorimit të telefonit të dorës, leximit dhe shkrimit të msm-ve/porosive në telefon. Kjo e rritë edhe më shumë rrezikun në trafikun rrugor.



Leximi i msm-ve në telefon celular është i rrezikshëm

Shkaqet e mundshme qe ka ardhur deri te kjo situatë e rrezikshme është përdorimi i telefonit të dorës – mobil, shkrimi dhe leximi i msm-ve.

## *Rreziqet e veçanta*

Shumica e rreziqeve të veçanta të cilat mund të ndodhin në trafikun rrugor kanë të bëjnë me situatat e papritura. p.sh. është shumë e vështirë shmangia e aksidentit në rastin kur duke lëvizur prapa një kamioni papritur bie ngarkesa e tij.
Në foton mëposhtme është paraqitur një situatë e rrezikshme kur vetura gjatë ngasjes prapa e rrezikon fëmijën me biçikletë, kjo ndodh kur shoferi para ngasjes nuk i bën një shikim vizual automjetit në të gjitha anët e tij. Kjo situatë mund të paraqitet edhe në ndonjë sipërfaqe tjetër jashtë rrugës qarkulluese (oborr, garazhdë, vendparkim,  park, etj.) ku mund të shkaktohet aksident trafiku.



Ngasja prapa e rrezikshme

*Shoferi është i obliguar që para ngasjes t'i bëjë veturës një shikim vizual.*

Gjatë ngasjss natën nëse automjeti i cili vjen përball i ndezë dritat e gjata, ju nuk duhet t'i ndezni dritat e gjata, pasi që mund të vijë deri te rrezikimi i trafikut rrugor,  por ju duhet të vazhdoni lëvizjen me dritat e shkurta dhe shikimin ta orientoni nga skaji i dajthtë i rrugës.



Përballkalim i rrezikshëm

Ndezja e dritave të gjata vështirëson ngasjen dhe të vërejturit e situatës në trafikun rrugor.

Shoferi gjatë ngasjes duhet të ketë kujdes që në pjesën e rrugës ku kryhen punimet mund të has personin i cili e bënë rregullimin e trafikut në mënyrë alternative me flamur apo me tabelë përkatëse.



*Kalim i lirë - vazhdim i ngasjss*

Shoferi i cili has në personin që punon në rrugë dhe i cili ka ngritur flamurin e gjelbër, kjo tregon kalimin e lirë, nëse i njëjti ka ngritur flamurin e kuq duhet të ndalet.



*Lëvizje e këmbësorës në rrugë qarkulluese*

Gjatë ngasjes në afërsi të veturave të ndalura apo të parkuara shoferi duhet të ketë më shumë kujdes sepse ndërmjet këtyre veturave mund të dalë ndonjë këmbësor apo shofer dhe të hap derën e automjetit pa shikuar trafikun nga prapa.

Dalja e këmbësores me karrocë fëmijësh ndërmjet automjeteve të parkuara paraqet rrezik në trafik.



*Situatë ku ngasja bëhet me kujdes të shtuar*

Në këtë situatë duhet të largoni këmbën nga pedalja e gasit dhe të jeni të gatshëm në rast nevoje të frenoni.

Pas shikimit të trafikut nga prapa sinjalizoni me kujdes të shtuar dhe kaloni në anë e majtë të rrugës duke mos e rrezikuar këmbësorin.



*Zonë e trafikut të qetë*

Gjatë ngasjes te kjo shenjë e lajmërimit, shoferi duhet pasur kujdes të ngas me shpejtësinë e lëvizjes së këmbësorit dhe mund të has fëmijë duke luajtur.

Nuk ju lejohet të përdorni burinë, nëse ndonjë pjesëmarrës ka vepruar në kundërshtim me rregullat e trafikut. Përkundër ju duhet të jeni tolerant që t'ia mundësoni lehtësimin e veprimit duke mos rrezikuar sigurinë në trafikun rrugor.



Ndaj automjetit të bardhë që ka shkelë rregullat e trafikut nuk lejohet përdorimi i burisë.

*Situatë e rrezikshme - të jeni gatshëm për frenim*

Shoferi duhet të ketë kujdes të shtuar ndaj veturës së autoshkollës pavarësisht se ora praktike e kandidatit për shofer mbahet nën mbikëqyrjen e instruktorit. Duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë mbajtjes së distancës së sigurisë, pasi kandidati në fjalë mund të bëjë ndonjë veprim të papritur. Njëkohësisht duhet edhe të jetë tolerant nëse i njëjti lëviz ngadalë, mos e përdorni burinë për t'ia tërhequr vëmendjen atij për të lëvizur më shpejtë.



*Ngasja e veturës të autoshkollës*

## *Ngasja në teposhtëze*

Gjatë ngasjes në teposhtëze duhet shfrytëzuar frenimin me motor, kjo realizohet duke vendosur shpejtësinë e përshtatshme, sa më e vogël shpejtësia frenimi me motor është më i madh dhe anasjelltas. Gjatë ngasjes së automjetit në teposhtëze nuk duhet fikur motori ngase te automjetet e reja vjen deri te mosfunksionimi i timonit, frenimit, etj.






*Ngasja në teposhtëze te rrezikshme*

Nuk duhet frenuar vazhdimisht me frenin punues sepse mund të vijë deri te nxehja e frenave dhe dështimi i frenit të punës. Në teposhtëze rritet distanca e sigurisë ndaj mjetit që lëviz përpara.

## *Ngasja në përpjetëze*

Shpejtësia e lejuar e ngasja në përpjetëze duhet t'i përshtatet kushteve të rrugës, sa më e vogël shpejtësia e lëvizjes aq më e madhe është fuqia e motorit dhe anasjelltas, nxitimi arrihet me vështerësi sesa në rrugë të rrafshët apo në teposhtëze, mund të haset në ndonjë mjet rrugor që lëviz ngadalë.
Rruga e ndaljes është më e shkurtë sesa në rrugë të drejtë dhe në teposhtëze.
Të gjitha këto kushte dhe rrethana duhet të merren parasysh kur kemi të bëjmë me ngasje të mjetit në përpjetëze.




*Ngasja në përpjetëze*

Nëse automjeti është i pajisur me pajisje inteligjente, përveç të tjerash, duhet t'i kushtohet rëndësi shpejtësisë me të cilën kërkohet të lëvizet.

## *Ngasja në kthesa*

Ngasja në kthesa është e rrezikshme për shkak të ndikimit të forcës centrifugale, sidomos nëse rruga është e rrëshqitshme dhe zvogëlohet kontakti i pneumatikëve me rrugën.
Para hyrjes në kthesa përshtatet shpejtësia e lëvizjes, pasi të kalohet mesi i kthesës gradualisht jepet gas, pasi të kalohet kthesa rritet shpejtësia e lëvizjes.



*Ngasja në kthesë të rrezikshme majtas*

## *Ngasja në kolonë*

Ngasja në kolonë paraqet ngasje të vështirë sidomos në përpjetëze, ku në disa raste duhet ngasë mjetin me gjysmëfriksion.
Duhet shmangur ndërrimin e shiritit, përveç në rastin kur rreshtimi bëhet me qëllim të daljes nga kolona ose për parkim.




*Ngasja në kolonë*

## *Ngasja gjatë erërave anësore*

Paraqet ngasje të rrezikshme për shkak të erërave anësore, sidomos për mjetet me dy rrota, mjetet transportuese dhe bashkësive të mjeteve.




Duhet pasur kujdes gjatë tejkalimit të mjeteve transportuese ose bashkësive të mjeteve për shkak të erërave anësore të mëdha pasi që pas tejkalimit të mjetit mund ta humbni lehtë drejtimin e lëvizjes.



*Ngasja gjatë erës anësore*

## *Ngasja në diell të fortë*

Gjatë ngasjes në diell të fortë mund të mos vërehen situatat e rrezikshme në trafik, përdorimi i mbrojtësve të diellit është i obligueshëm.



*Ngasja në diell të fortë është e rrezikshme.*

*Ngasja në diell të fortë*

Duhet të jeni të kujdesshëm gjatë ngasjes, të lëvizni me shpejtësi të përshtatshme varësisht nga intensiteti i dritës së diellit dhe nga kushtet e trafikut.

### *Ngasja në shi*

Ngasja në shi, përveç zvogëlimit të pamjes dhe zvogëlimit të koeficientit të fërkimit të pneumatikëve me sipërfaqen e rrugës, karakterizohet me rrezikun e shpeshtë të defektit të frenit punues i cili laget nga shiu si dhe vështirësohet të drejtuarit të automjetit ku paraqitet fenomeni i ashtuquajtur *“pyka e ujit”* (jastëku i ujit - aquaplaning).



*Ngasja në shi*

Gjatë shirave të mëdha dhe pas tyre, zakonisht formohen pyka uji në rrugë dhe kur automjeti me shpejtësi të madhe has në to, vjen deri te mbulimi i përkohshëm i xhamit mbrojtës duke zvogëluar pamjen nga automjeti.
Të njëjtat raste paraqiten edhe me rastin e përballkalimit dhe tejkalimit, kur një sasi uji në rrugën qarkulluese, automjetet e tjera e hedhin në xhamin mbrojtës të automjetit qe jeni duke lëvizur ose anasjelltas.
Rruga është veçanërisht e rrëshqitshme gjatë kohës me shi (në fillim kur bie shi), kur në të ka pluhur, yndyrë, baltë, fletë, vaj motori të derdhur, etj. Meqenëse koeficenti i fërkimi në këso raste është i zvogëluar, rruga e frenimit është më e gjatë, frenat mund të lagen dhe kjo bën që rreziku në trafik të rritet edhe më shumë. Në këto kushte të rrugës së rrëshqitshme duhet të drejtohet me shpejtësi të përshtatshme, frenimi të bëhet me motor (duke kaluar nga shpejtësia më e lartë në më të ulët).

## SEZONI DIMËROR

Gjatë sezonit dimëror, nga 15 nëntori deri më 15 mars, automjetet dhe bashkësitë e mjeteve që marrin pjesë në trafikun rrugor duhet t’i kenë pajisjet dimërore.



*Ngasja në rrugët e mbuluara me borë*

Gjatë kushteve dimërore ndalohet qarkullimi i automjeteve dhe i bashkësisë së mjeteve të cilat nuk i kanë të vendosura pajisjet dimërore.

Kushtet dimërore nënkuptojnë rrugën e mbuluar me borë ose akull.

Mundësia e lëvizjes së automjetit varet në masë të madhe nga trashësia e borës dhe pesha e bartjes së lëvizshmërisë së automjetit si dhe shkathtësitë e shoferit.
Metoda e të drejtuarit të automjetit nëpër borë mundësisht duhet të jetë kjo: pa ndërrim të shpeshtë të shpejtësive, pa nxitim dhe ngadalësim të vrullshëm, kthim të vrullshëm të timonit, etj.




*Rruga e mbuluar me borë*

## *Ngasja në rrugët e mbuluara me ngrica*

Karakteristikat themelore të ngasjes së automjetit nëpër rrugët me ngrica kanë të bëjnë me zvogëlimin e fërkimit me sipërfaqen e rrugës, rrëshqitjen, vështirësinë e të drejtuarit, rrezikun nga kthimi dhe rrokullisjen e automjeteve etj.





*Rruga e mbuluar me ngrica*

## Ngasja në mjegull

Ngasja në mjegull karakterizohet me dukshmëri të dobësuar (zvogëlim të pamjes) dhe lagështi që krijohet nga mjegulla në sipërfaqe të rrugës qarkulluese.



Përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes

Mund të mos vërehen me kohë këmbësorët dhe mjetet që nuk kanë ndriçim vetanak.

*Ngasja në mjegull*

Të pamurit është i kushtëzuar nga dendësia e mjegullës, pastaj nga mjegullimi i xhamave në kabinë si dhe nga përdorimi i dritave për ndriçimin e rrugës (të shkurta ose të mjegullës apo mund të jenë të dyja të ndezura në të njëjten kohë) si dhe nga dritat e automjeteve që vijnë përball.
Problemi kryesor i të drejtuarit të automjetit në këto kushte është orientimi i vështirësuar në hapësirë dhe vlerësimi i gabuar i gjerësisë dhe lartësisë, etj.
Shpejtësinë e lëvizjes duhet zvogëluar proporcionalisht me zvogëlimin e të pamurit dhe në funksion të rrugës së ndaljes.

## Ngasja natën

Ngasja natën karakterizohet me dukshmëri të dobësuar (kufizim i të pamurit) e që varet nga përdorimi i dritave për ndriçimin e rrugës.
Shpejtësia e lëvizjes varet nga përdorimi i dritave për ndriçim të rrugës dhe në funksion të rrugës së ndaljes.



*Dukshmëria e dobësuar*

*Ngasja natën*

Gjatë ngasjes natën kujdesi duhet të jetë edhe më i madh për shkak se lodhja shfaqet më shpejtë, mund të mos vërehen këmbësorët apo mjetet pa ndriçim vetjak. Veçanërisht duhet pasur kujdes të shtuar kur gjatë ngasjes kalohet nga pjesa e pandriçuar në pjesën e ndriçuar të rrugës ose anasjelltas.

# 7. ASPEKTI MEKANIK QË KA TË BËJË ME SIGURINË RRUGORE

# AUTOMJETI

Automjeti është faktori bazë i sigurisë rrugore dhe mosmirëmbajtja e tij ndikon në ndotjen e mjedisit. Nëse automjeti mirëmbahet rregullisht dhe servisimet kryhen me rregull do të ketë rritje të sigurisë rrugore, mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të rrjedhës normale të trafikut si dhe qëndrueshmëri të tij.

Shprehjet e përdorura në këtë kapitull kanë këtë kuptim.

**Automjet** - çdo mjet që lëviz në rrugë me fuqi të motorit të vet, i cili sipas konstruksionit, pajisjeve, veglave e pajimeve është paraparë për transport të personave, përkatësisht të ngarkesave / mallit, për kryerje të punëve a për tërheqje të mjeteve të bashkëngjitura, përveç mjeteve që lëvizin nëpër binarë.



*Vetura*

**Veturë** - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti edhe tetë (8) ulëse të tjera.

**Mjet rrugor** - çdo mjet transporti që lëviz nëpër rrugë, përveç karrocave lëvizëse pa motor për persona me aftësi të kufizuara dhe mjeteve transportuese të fëmijëve.

**Bashkësi mjetesh** - mjet me veprim motorik dhe mjet i bashkëngjitur, që në trafikun rrugor marrin pjesë si tërësi.

## Njohuritë e pajisjeve dhe defekteve të motorit



**Motori**

**Motori -** *shërben për të prodhuar forcën tërheqëse për lëvizje të automjetit.*

**Pajisjet qe mundësojnë punën e motorit janë:**

- ***pajisja për ftohje,***
- ***pajisja  për lubrifikim (vaji,)***
- ***pajisja për furnizim me kurbarante,***

**Shkaqet e mundshme të bllokimit të motorit janë:**

- ***mosfunksionimi i sistemit për ftohje,***
- ***mosfunksionimi i sistemit  për lubrifikim (vaji).***

**Shkaqet e mundshme për ndezjen e dritës së kuqe të temperaturës në tabelën kontrolluese janë:**

- **mosfunksionimi i sistemit për ftohje,**
- **sasia e pamjaftueshme e ujit.**

**Shoferi njoftohet se temperatura e motorit e ka kaluar kufirin e lejuar nëse treguesi i temperatures kalon në fushën e kuqe (ndizet drita kontrolluese e ujit).**

***Tab. Pajisjet e veturës destinimi dhe funksionimi i tyre***

| | |
|---|---|
| **Tabela kontrolluese (komanduese) në automjet mundëson përcjelljen e punës së motorit. Ajo tregon kilometrat e kaluar dhe shpejtësinë e lëvizjes.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon)  problemin me  motor.** |  |
| **Pajisja për ftohje (lëngu/uji) mundëson punën e motorit** |  |
| **Shtypja e ulët të ajrit në pneumatik (goma) zvogëlon stabilitetin e mjetit dhe dëmton pneumatikët, rrit shpenzimet e karburantit.** |  |
| **Timoni shërben për  drejtimin e automjetit në kahun e dëshirueshëm.** |  |

| | |
|---|---|
| **Sistemi ABS në automjet mundëson që në rast të frenimit të mos vijë deri te bllokimi i rrotave.** |   |
| **Pedalja e friksionit të cilën duhet shtypur para aktivizimit të motorit mundëson nisjen ngavendi dhe ndërrimin e shpejtësive.** |  |
| **Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se temeperatura e motorit e ka kaluar kufirin e lejuar – defekt në sistem të ftohjes.** |  |
| **Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) sasinë e pamjaftueshme të vajit në motor apo defektin në sistemin e lubrifikimit.** |  |
| **Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se në automjet janë të ndezura dritat e shkurta.** |  |
| **Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se në automjet janë të ndezura dritat e gjata.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) dritat për mjegull** |  |
| **Treguesit e drejtimit përdoren gjatë veprimeve me automjet (tejkalimi, kthimi majtas ose djthtas, etj).** |  |
| **Llampa kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) në automjet janë të ndezura të gjithë treguesit.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se alternatori  nuk është duke funksionuar si duhet.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se tempomati është i aktivizuar** |  |

| | |
|---|---|
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se freni i parkimit është jashtë funksionit.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se rripi i sigurisë nuk është vendosur.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se ESP / Programi Elektronik i Stabilitetit është jashtë funksionit** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) sasinë e karubrantit** |   |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) probleme me jastëk të ajrit.** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se nxehësit janë jashtë funksionit (Dizel).** |  |
| **Llamba kontolluese sinjalizon (tregon) se servo timoni nuk është në rregull.** |  |
| **Regjimi EKOLOGJIK** |  |
| **Distanca e sigurisë e vogël.** |  |

| | |
|---|---|
| **Numri i rrotullimeve të motorit.** |  |
| **Numëri i rrotullimeve të motorit  në fushën e kuqe.** |  |

**Timoni-** shkaqet e mundshme që timoni dridhet gjatë ngasjes janë: shtypja e ajrit në pneumatikë (goma) në boshtin e përparmë nuk është e njëjtë, lëvizja e timonit është mbi kufijtë e lejuar, dhe rrotat janë të pabalancuara.

**Friksioni** (kuplungu) shërben për nisjen e mjetit nga vendi dhe ndërrimin e shpejtësisë gjatë ngasjes.

**Sistemi elektrik i automjetit siguron rrymën për:**

- aktivizimin e motorit të automjetit,
- funksionimin e pajisjeve sinjalizuese të automjetit,
- funksionimin e pajisjeve ndriçuese të automjetit.

***Shkaqet e dobësimit të baterisë janë:***

- ndonjë defekt në sistemin elektrik,
- nëse dritat harrohen të ndezura kur parkohet mjeti.

***Në sistem të frenimit bëjnë pjesë:***

- freni punues (i këmbës),
- freni ndihmës,
- freni i parkimit.

***Freni punues veprues vepron në të gjitha rrotat.***

**Sistemi ABS në automjet,** pamundëson bllokimin e rrotave në rast frenimi.
**ESP / Programi Elektronik i Stabilitetit,** mundëson stabilitetin e automjetit gjatë ngasjes në kthesa të ashpëra.

## Pajisjet e transmisionit janë:

- *friksioni,*
- *ndërruesi i shpejtësisë,*
- *boshti i kardanit.*

**Freni ndihmës** i mjetit shërben për zvogëlimin e shpejtësisë së mjetit në rast të mosfunksionimit të frenit punues.

## *Pneumatikët*

Pneumatikët janë pjesë kryesore të rrotës që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me rrugën dhe i transmetojnë forcat, me të cilët automjeti vepron mbi rrugë. Pneumatikët ndikojnë në të gjitha karakteristikat e automjetit të cilat varen nga cilësia e kontaktit në mes të pneumatikëve dhe rrugës, si: karakteristikat e frenimit dhe ato dinamike, drejtueshmërinë, si dhe ndikojnë në rehatinë gjatë ngasjes dhe në shpenzimet e karburanteve.

.




Në vijim është paraqitur shenja e një gome radiale për automjete transportuese:

10.00 R 20 146 / 143 K TT,

ku janë:

10.00 - gjerësia nominale e gomës (B) në cole;
R - shenja e gomës radiale,
20 - diametri nominal i bandazhit (d) në cole;
146/143 - indeksi i bartësisë,
K - shenja e shpejtësisë (maksimalja 110 km / h),
TT / tube type (lloji/tipi i tubit) dhe TL / tubeless tyres (goma pa tub).

# 8. PAJISJET PASIVE TË SIGURISË SË AUTOMJETIT

# ELEMENTET PASIVE TË SIGURISË SË AUTOMJETIT

Elementet pasive të sigurisë së automjetit janë ato elemente të cilat zbusin pasojat e aksidenteve në trafik.

Në elementet pasive të sigurisë së automjetit bëjnë pjesë: rripat e sigurisë, mbështëtësit e kokës jastëku i ajrit, pasqyrat e shoferit, etj..

## *Përdorimi i rripit të sigurisë*

Shoferi dhe të gjithë personat të cilët gjenden në automjet, duhet t'i përdorin rripat e sigurisë ashtu siç e parasheh prodhuesi i automjetit.
Nëse personi i mitur i cili transportohet në mjet nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia bie mbi shoferin e mjetit, ndërsa nëse personi i moshës madhore nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësinë për këtë e mban vetë personi.

Nëse nuk përdoret rripi i sigurisë gjatë frenimit të vrullshëm dhe në rast të shkaktimit të aksidentit rrugor, te shoferi dhe personat tjerë në automjet mund të shkaktohen lëndime trupore të lehta apo të rënda ku si pasojë lëndohet koka, gjymtyrët, thyhen brinjtë, vjen deri te gjakderdhjet e brendshme të rënda etj.



Pozita e shoferit i cili nuk e ka përdorur rripin e sigurisë.



Pozita e shoferit i cili e ka përdorur rripin e sigurisë.

*Rripi i sigurisë*



*Rripi i sigurisë*

Rripi i sigurisë përdoret me rastin e nisjes së automjetit si brenda ashtu edhe jashtë zonës urbane.

## *Mbështetësit e kokës*



Mbështetësit për kokë janë pajisje pasive jo obliguese, por nëse automjeti është pajisur për shkaqe sigure duhet të përdoren.
Gjatë goditjes së papritur të automjetit në pjesën e prapme vjen deri te lëvizja e kokës prapa, me ç`rast mund të shkaktohet edhe lëndimi i qafës.
Me qëllim të shmangies së këtyre lëndimeve instalohen mbështetësit e kokës të cilët duhet të jenë të përshtatshëm dhe të ofrojnë mbështetje të mirë të kokës.

### *Ulësja e sigurisë për fëmijë*

Fëmijët nën moshën 12 vjeç dhe me lartësi nën 150 cm të cilët transportohen në mjetet të cilat kanë të instaluar rripa të sigurisë, duhet të jenë të siguruar tërësisht apo pjesërisht me sistem të sigurt, d.m.th. me ulëse të sigurisë për fëmijë, të përshtatur për masën dhe lartësinë e fëmijëve.



*Ulësja e sigurisë për fëmijë*

Në mjetet të cilat nuk kanë të instaluar sistem të sigurisë, d.m.th. ulëse të sigurisë për fëmijë, nuk lejohet të transportohen fëmijë më të vegjël se tre 3 vjeç.

Në mjete nuk lejohet të ulen në ulëset e para fëmijë nga 3 e më shumë vjeç dhe me lartësi nën 150 cm.

Nëse fëmija është nën përkujdese të personit të moshës madhore që nuk është i ulur në ulëset e përparme të mjetit, përkatësisht nëse mbahet në prehër apo në duar të këtij personi, lirohet nga detyrimi për ta përdorur ulësen e sigurisë për fëmijë.

## *Personat të cilët lirohen nga përdorimi i rripit të sigurisë*

Detyrimi për ta përdorur rripin e sigurisë nuk zbatohet për këta persona:

- personin që posedon certifikatë mjekësore me të cilën vërtetohet se i shfaqen efekte anësore, negative poqese e përdor rripin e sigurisë,
- gruan shtatzënë.

## *Jastëku mbrojtës (i ajrit) / air bag*



*Jastëku mbrojtës*

Shërben për parandalimin e lëndimeve të shoferit dhe bashkëudhëtarëve në rast aksidenti. Aktivizohet në mënyrë automatike në rast të aksidentit apo ndonjë pengese të fortë në rrugë.

## *Pasqyrat*



*Pasqyret*

Për vështrimin e trafikut mbrapa dhe nga anët anësore të automjetit, rregullohen pasqyrat nga ana e shoferit.

# 9. EKO - NGASJA

# *EKO - NGASJA*



*Me Eko - Ngasje nënkuptojmë të drejtuarit e automjetit që ndikon drejtëpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë rrugore dhe në kursim të karburantit.*

***Eko - ngasja është një metodë e re e ngasjes që e bënë më të lehtë përdorimin e pajisjeve inteligjente të automjetit, njëkohësisht ndikon edhe në përmirësimin e sigurisë rrugore.***

## Objektivat e Eko – ngasjes janë:

- *mbrotja e mjedisit,*
- *shpenzimet minimale (më të vogla) të karburanteve.*

### Parimet e Eko - Ngasjes janë:

- *ngasja e njëtrajshme,*
- *fikja e motorit gjatë pritjeve të gjata,*
- *nisja graduale e automjetit,*
- *zgjatja e qëndrueshmërisë së automjetit,*
- *mospërdorimi i automjetit në relacione të shkurta,*
- *ndërrimi me kohë i shpejtësive,,*
- *ngarkesa e panevojshme në bagazhë,*
- *ngasja me numër të mesëm / optimal të rrotullimeve të motorit,*
- *ngasja pa nxitim dhe frenim të vrullshëm,*
- *pneumatikë me presion adekuat,*
- *në përpjetëze ndërruesi vihet në shpejtësinë që nuk çon deri te nxemja e motorit,, sa më e vogël shpejtësia aq më e madhe fuqia e motorit dhe anasjelltas,*
- *në teposhtëze ndërruesi vihet në shpejtësinë që nuk kërkon frenim të vazhdueshëm (përdoret frenimi me motor, sa më e vogël shpejtësia aq më i madh efekti i motorit për frenim),*
- ***ngadalësimi me kohë i mjetit te drita e kuqe në semafor,***

- ***fikja e motorit kur duhet pritur më gjatë para vendkalimit hekurdhor dhe kolonës e cila*** *është e ndalur,* ***si dhe kur*** *duhet pritur më gjatë se një minutë në tunel,*
- ***kontrollimi i sasisë së monoksidit të karbonit (CO), e gazrave dalëse,***
- ***ndërrimi i vajit në vendet e parapara për këtë qëllim,***
- ***pastrimi i mjetit në vendet e parapara për këtë qëllim,***
- ***moslejimi i rrjedhjes së vajit nën automjet,***
- ***hedhja e gomave të harxhuara në vende përkatëse,***
- ***shmangia e ngasjes kur trafiku është i dendur.***

## Për Eko - ngasje duhet të keni (posedoni):

- *njohurië (funksionimi) për automjetin,*
- *aftësi për ngasje,*
- *njohuri për përdorimin e pajisjeve inteligjente të automjetit.*

## Teknika e Eko - ngasjes përfshinë:

- *nisjen e menjëhershme pas aktivizimit të motorit,*
- *kalimin sa më të shpejtë në shpejtësi më të lartë të lëvizjes,*
- *përshtatjen e rrotullimeve të motorit, ndërrimin me kohë të shpejtësisë,*
- *perceptimin sa më të mirë të situatës në trafik (parashikimin me kohë të veprimeve të pjesëmarrësve të tjerë në trafik),*
- *ngasjen me shpejtësi konstante,*
- *parashikimin e rrjedhës së trafikut,*
- *fikjen e motorit gjatë pritjeve të gjata, ngecjes në trafik, semaforë, etj.,*
- *frenimin me kohë dhe mosnxitimin pa nevojë dhe në mënyrë të vrullshme,*
- *planifikimin paraprak të marshutës.*

### Faktorët me ndikim negativë në Eco - ngasje

- *mbingarkesa në mjet,*
- *gjendja e pneumatikëve (presioni i ulët në pneumatikë),*
- *ngasja me rrotullime shumë të larta të motorit.*

Sipas rregullave të trafikut, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, është paraparë që shoferit nuk i lejohet:

- *ta shfrytëzojë mjetin në atë mënyrë që të lëshojë tym të tepruar duke e ndotur mjedisin os që bën zhurmë më shumë sesa është e paraparë me rregulla,*
- *ta lërë motorin të ndezur gjatë parkimit brenda vendbanimit.*

# LITERATURA:


1. *Ligji për Rregullat e trafikut rrugor.*
2. *Ligji për Patentë shoferi.*
3. *Rregullat e trafikut dhe siguria rrugore me metodikën.*
4. *Akte nënligjore nga ligji për Rregullat e trafikut rrugor dhe patentë shoferi.*
5. *Xhevat Gashi- Patentë Shoferi për kategorinë A dhe B.*
6. *Burime nga interneti.*
7. *Burime tjera.*